



Population Research Center  
University of Groningen

**INDEX  
KOSOVA**

*Joint venture with BBSS  
Gallup International*

# Shtatzënia dhe Planifikimi Familjar në Kosovë

Studim Kualitativ

Dhjetor 2006



**SHTATZËNIA DHE PLANIFIKIMI FAMILJAR NË  
KOSOVË  
STUDIM KUALITATIV**

**AUTORËT: VLORA BASHA, INGE HUTTER**

Dhjetor 2006



## PËRMBAJTJA

5. LISTA E SHKURTESAVE

### 7. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

#### 11. HYRJE: STUDIMI MBI ABORTIN NË KOSOVË

12. Çështjet dhe qëllimet

13. Metodologjia

14. Ky raport

#### 17. KAPITULLI 1 SHOQËRIA KOSOVARE NË NDRYSHIM E SIPËR

17. MODERNIZIMI DHE VARFËRIA

19. FAMILJA

20. NDRYSHIMET NË JETËN E FEMRAVE

21. MARRËDHËNIET RECIPROKE

22. MENDIMET PËR SEKSIN PARA-MARTESOR

25. ORIENTIMET SEKSUALE NË DYSHIM

26. PERCEPTIMET PËR SHTATZËNINË DHE PËR KUJDESIN PARA LINDJES

26. Përkrahja familjare

27. Kujdesi i nënës

28. Shërbimet para lindjes

#### 31. KAPITULLI 2 ABORTI I NXITUR

32. PERCEPTIMET PËR ABORTIN: DISA DALLIME

34. ARSYET PËR ABORT – MJET PËR PLANIFIKIM FAMILJAR?

34. Arsyet financiare

35. Kompleksi gjyshe

35. Zgjedhja e gjinisë

36. Aborti 'spontan'

36. Shtatzënitë tepër të shpeshta dhe të shumta

37. Moshë e re femrës

37. 'Ato për të cilat nuk flasim'

38. NJOHURIA PËR METODAT E ABORTIT

39. PASOJAT E PERCEPTUARA TË ABORTIT

40. NDJENJAT PËR ABORTIN

41. KOHA PËR ABORTE

42. KU TË KRYHET ABORTI (TË MARTUARAT NDAJ TË PAMARTUAR-  
AVE)

**47. KAPITULLI 3 NJOHURIA PËR MJETE KONTRACEPTIVE DHE SHFRYTËZIMI I TYRE**

- 50. ABORT, PASTAJ MJETE KONTRACEPTIVE?
- 51. DISPOZITIVI INTRAUTERIN – DIU (SPIRALJA)
- 52. TABLETAT ‘KUNDËR SHTATZËNISË’
- 53. SHFRYTËZIMI I PREZERVATIVËVE
- 55. “NDAL KUR ËSHTË MË SË ËMBLI”: METODA E TËRHEQJES

**59. KAPITULLI 4 PËRMBLEDHJE, KONKLUZA, DISKUTIM DHE REKOMANDIME**

- 60. Abortet
- 61. Mjetet kontraceptive

**62. REKOMANDIMET**

**66. SHTOJCA 1 PLANI I MOSTRËS**

**68. SHTOJCA 2 INSTRUMENTET E SHFRYTËZUARA NË STUDIM**





## LISTA E SHKURTESAVE

|       |   |
|-------|---|
| UNFPA | United Nations Population Fund (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë)            |
| PRC   | Population Research Centre (Qendra për Hulumtime të Popullsisë)                         |
| UNDP  | United Nations Development Programme (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim)     |
| KHDR  | Kosovo Human Development Report (Raporti për Zhvillimin Njerëzor për Kosovën)           |
| PSSP  | Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm                                       |
| PPFA  | Planned Parenthood Federation of America (Federata për Planifikim Prindëror e Amerikës) |
| OJQ   | Organizatë Jo-Qeveritare  |
| DIU   | Dispozitivi intrauterin (Spirale)   |







## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky raport përshkruan perceptimet dhe mendimet, edhe të femrave edhe të meshkujve, për abortin dhe shfrytëzimin e mjeteve kontraceptive në shoqërinë e Kosovës që është në ndryshim e sipër. Këto perceptime dhe mendime janë të ndërlidhura me trendet sociale, si kushtet e rënda ekonomike në Kosovë, por edhe me modernizimin, ndikimin e diasporës që ofron përkrahje financiare që është e nevojshme për familjet e tyre në Kosovë, mendimet e ndryshueshme për seksin paramartesor dhe sjelljet tjera seksuale, vlerat e ndryshueshme mbi abortin dhe kujdesin para lindjes të ofruar në shërbimet shëndetësore dhe mbi të gjitha, pozitën në ndryshim e sipër të femrave në shoqëri.

Në mënyrë që të hulumtohen më thellësisht arsyet për zgjedhjen e abortit, si dhe mendimet dhe perceptimet për abortin në marrëdhënie me kontrollin e lindjeve, ky studimi ka përfshirë një hulumtim kualitativ ku janë kryer edhe diskutime në grup edhe intervista të thella në regjionet rurale dhe urbane të Kosovës.

Diskutimet në grup dhe intervistat e thella zbulojnë se aborti është mjaft i zakonshëm në Kosovë. Femrat e martuara dhe të pamartuara tregojnë perceptime, arsye dhe pasoja të ndryshme në lidhje me abortin.



Aborti në përgjithësi është i pranueshëm nëse kryhet për shkaqe shëndetësore, për shkak të abnormalitetit të fetusit dhe dhunimit. Gjithashtu, mendimi i përgjithshëm në mesin e femrave të martuara është se aborti është mjaft i pranueshëm. Kushtet financiare është çështja kryesore që i shtyn femrat të zgjedhin abortin (duke mos qenë në gjendje ta mbajnë edhe një fëmijë). Arsye tjera janë: shtatzënia menjëherë pas lindjes së mëparshme, nuk dëshiron fëmijë tjetër, preferenca për djalë (zgjedhja e gjinisë) dhe kompleksi i gjyshes (shtatzënë me fëmijë dhe gjyshe në të njëjtën kohë).

Abortet në mesin e femrave të pamartuara janë diçka që nuk mund të përmenden. Edhe pse mendimet për seksin paramartesor janë duke ndryshuar, sidomos në Prishtinë, mendimet për femrat që kanë mbetur shtatzënë para martesës dhe nevoja e tyre për abort, ende reflektojnë vlerat themelore tradicionale (meshkujt duhet të martohen me virgjëresha). Meshkujt e rinj i përmbahen moralit të dyfishtë: ata mendojnë se seksi paramartesor duhet të ekzistojë, por ata nuk do të martoheshin me një femër që ka pasur seks paramartesor.

Metoda e tërheqjes është metoda më e popullarizuar dhe më e preferuar për kontrollin e lindjeve. Fatkeqësisht, femrat që varen nga burrat e tyre që kjo metodë të ketë sukses ndonjëherë mbeten shtatzënë për shkak të moskujdesit të burrave të tyre. Pjesëmarrëset përmendën raste kur burrat kanë qenë të pakujdesshëm për shkak të pijes (alkoolit). Pjesëmarrëset gjithashtu kanë theksuar rëndësinë e besimit reciprok në mes të burrit dhe gruar gjatë shfrytëzimit të kësaj metode.

Femrat tregojnë se dobësi kryesore e përdorimit të mjeteve moderne kontraceptive si tabletat, prezervativët dhe spiralet (DIU) janë efektet anësore nga të gjitha këto metoda, edhe pse ekziston një mangësi e madhe e informimit për efektet e vërteta anësore. Shumica e femrave i marrin informatat për mjetet kontraceptive nga thashethemet, nga miqtë, fqinjët, të afërmit, e jo drejtpërdrejt nga profesionistët. Prezervativët janë veçanërisht të popullarizuar në mesin e të rinjve. Kjo është kryesisht për shkak të fushatave informative për parandalimin e HIV-it (e jo për parandalimin e shtatzënive).

Rekomandimet për përpiluesit e politikave dhe për intervencionistët fokusohen në ofrimin e informatave, ashtu që femrat të jenë në gjendje të marrin vendime të informuara dhe këshillime, edhe për abort edhe për mjetet kontraceptive, ngritjen e kualitetit të kujdesit para lindjes dhe ofrimin e edukimit seksual, sidomos për të rinjtë.





## HYRJJE: STUDIMI MBI ABORTIN NË KOSOVË

Në Kosovë janë kryer disa studime mbi shëndetin e përgjithshëm dhe atë riprodhues, përfshirë edhe çështje për shëndetin e femrave dhe meshkujve, përfshirë edhe abortin. Vlerësimet e UNFPA-së (2000) tregojnë se për çdo 100 lindje të gjalla kryhen 4.8 aborte. Në vitin 2002, UNFPA raportonte 5 aborte për 100 lindje të gjalla. Që të dy vlerësimet janë të dhëna të mbledhura nga spitalet e përgjithshme, por jo edhe nga klinikat private. Duke marrë parasysh se një numër i madh i aborteve kryhet në klinika private, këta numra nuk janë të plotë.

Asnjëri nga këto studime nuk e ka mbuluar çështjen e abortit thellësisht. Nuk janë dokumentuar as qëndrimet e përgjithshme shoqërore për abortin, e as arsyet dhe pasojat.

Ky raport ka për qëllim ta plotësojë këtë zbrazëti, jo vetëm duke mbledhur dhe duke paraqitur informata për të gjitha këto çështje, por edhe duke formuluar rekomandime për përpilimin e politikave dhe intervenimeve në Kosovë.

Ky studim mbi abortin është iniciuar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) në Kosovë. UNFPA në Kosovë është themeluar në korrik të vitit 1999 si pjesë e programit për përgjigje emergjente me qëllim të përgjithshëm për të rikthyer kushtet elementare dhe të sigurta për femrat dhe foshnjat e tyre të porsalindura. Aktualisht, UNFPA kontribuon në ndërtimin e



kapaciteteve në lëmin e shëndetit riprodhues për ofruesit e shërbimeve shëndetësore dhe promovimin e shëndetit riprodhues në mesin e meshkujve, femrave dhe të rinjve në përgjithësi.

Studimi u implementua nga Qendra për Hulumtime të Popullsisë (PRC) e Universitetit të Groningenit (Holandë) dhe Index Kosova partner me BBSS Gallup International (Kosovë), si partner implementues lokal.

Hulumtimi kuantitativ nuk u vlerësua si metodë adekuate për të studiuar abortin, pasi që të dhënat e mbledhura mund të mos jenë të sigurta dhe relevante, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e kësaj çështjeje. Roli i abortit në fertilitetin dhe shëndetin e femrave, motivet e tyre për të zgjedhur abortin dhe hollësitë lidhur me jetën riprodhuese të femrave në Kosovë, janë të gjitha çështje që kërkojnë më shumë krijim të marrëdhënies dhe besimit në mes të hulumtuesve dhe respondentëve. Prandaj janë përdorur metodat kualitative të hulumtimit për të ofruar informata të sigurta dhe të thella për abortin.

## Çështjet dhe qëllimet

Qëllimi kryesor i studimit ishte që të merren parasysh:

**Historitë e shtatzënive:** Cilat janë historitë e shtatzënive të femrave (shtatzënia, dështimi, aborti, lindja e frytit të vdekur, lindja e frytit të gjallë)? Cilat shërbime të paralindjes janë në dispozicion?

**Shtatzënitë e padëshiruara:** Çka mendojnë femrat, cilat opsione i kanë kur kanë shtatzëni të padëshiruar? Pse është shtatzënia e tyre e padëshiruar? A kanë përdorur mjete kontraceptive (tradicionale/moderne)? Cilat janë njohuritë e tyre për mjetet kontraceptive? Kur është aborti opsion? A janë ato të martuara, të pamartuara? Çështja e barazisë, mosha, numri i djemve/vajzave, shëndeti?

Si i marrin femrat **vendimet**? Cilat çështje merren parasysh? Çfarë hapa ndër-marrin? Ku i marrin informatat?

**Vendi dhe informimi:** Çka mendojnë femrat, ku mund të abortojnë? Në cilat institucione (publike/private)? Çka mendojnë femrat se si kryhet procedura? A ofrohen informata për shërbimet, metodën si kryhet? Kush e ofron këtë informatë? A ofrojnë shërbimet shëndetësore informata, punëtorët shëndetësorë ose femrat tjera në komunitet?

**Konteksti shoqëror:** Me kë këshillohen femrat? Ku i marrin këto informata; me kë flasin lidhur me këtë? A u nevojitet femrave leja, nga kush? Cili është ndikimi i familjes së burrit, ndikimi i burrit, shoqëria patriarkale? Në lidhje me këtë:

**Konteksti gjinor:** A i marrin vendimet femrat vetë për vete, apo varen nga dikush tjetër? Cili është ndikimi i statusit të femrave në shoqërinë kosovare? A luan rol preferenca gjinore në abort? A shikohet zgjedhja për abort ndryshe nëse fetusi është djalë ose vajzë?

**Konteksti kulturor:** Çfarë roli kulturor kanë fëmijët? A ka dallime gjinore? Çfarë kuptimi kanë aborti dhe mjetet kontraceptive për femrat dhe për shoqërinë kosovare në përgjithësi?

## Metodologjia

Në mënyrë që të arrihen këto qëllime, Index Kosova partner me BBSS Gallup International zhvilloi 19 diskutime në grup dhe 18 intervista të thella. Përmes këtyre metodave u mbledhën informata të përgjithshme duke biseduar me femrat në diskutime në grup, si dhe informata më të hollësishme për abortin duke intervistuar femrat që kanë pasur abort.

Diskutimet në grup dhe intervistat e thella u zhvilluan në: Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë, me shqiptarë të Kosovës, dhe Mitrovicë dhe Çagllavicë me serbë të Kosovës. Mostra ka përfshirë pjesëmarrës/e nga regjionet urbane dhe rurale.

Nga 19 diskutime në grup, 12 janë zhvilluar me femra shqiptare të Kosovës, 4 me femra serbe të Kosovës, 2 me meshkuj (Prishtinë dhe Prizren) dhe 1 grup me gjinekologë (Prishtinë).

Procesi i rekrutimit përmes zgjedhjes së rastit për diskutimet në grup ishte shumë më i lehtë sesa rekrutimi përmes zgjedhjes së qëllimshme për intervistat e thella. Pjesëmarrësit në diskutimet në grup, kryesisht femra, folën lirshëm për abortin në përgjithësi dhe treguan histori për të afërmit dhe miqtë e tyre. Megjithatë, ato hezitonin kur diskutohej për përvojat e tyre personale.

Intervistat e thella u zhvilluan me femrat që kanë pasur aborte. Shumica e respondentëve duhej të kërkohej shtëpi-më-shtëpi në regjionet e veçanta nga stafi i Index Kosovës. Intervistat e thella u zhvilluan me grupe të ndryshme etnike të femrave në Kosovë. Këto intervista u kryen me femra që kanë pasur abort: 9 intervista të thella me femra shqiptare të Kosovës, 6 me femra RAE të Kosovës dhe 3 me femra serbe të Kosovës.



## **Ky raport**

Kapitulli 1 përshkruan shoqërinë kosovare që është në ndryshim e sipër, në mënyrë që plotësisht të kuptohet aborti dhe sjellja ndaj mjeteve kontraceptive në kontekstin ekonomik, social, gjinor dhe kulturor të shoqërisë. Këtu shkurtimisht përshkruhet situata ekonomike dhe tranzicionet sociale që kanë ndodhur që nga konflikti i vitit 1999; pozita e ndryshueshme e femrave; mendimet e ndryshueshme për seksin paramartesor dhe sjelljet tjera seksuale; dhe perceptimet e ndryshueshme për shtatzëninë dhe kujdesin paralindjes.

Kapitulli 2, thelbi i këtij raporti, përshkruan perceptimet e përgjithshme për abortin, arsyet dhe pasojat e perceptuara, metodat dhe ndjenjat dhe përvojat e perceptuara, ashtu si janë paraqitur nga pjesëmarrëset edhe në diskutimet në grup edhe në intervistat e thella.

Kapitulli 3 përshkruan mendimet e ndërlidhura me përdorimin e mjeteve kontraceptive dhe thekson dominimin e përgjithshëm të metodës së tërheqjes.

Kapitulli 4 përmbledh rezultatet dhe konstatimet, dhe përfundon me rekomandime për përpilimin e politikave dhe intervenimet në fushën e abortit dhe përdorimit të mjeteve kontraceptive.







## KAPITULLI 1 SHOQËRIA KOSOVARE NË NDRYSHIM E SIPËR

Kosova aktualisht është duke kaluar nëpër një tranzicion që ka ndryshuar dhe ka modifikuar jetën e përgjithshme të njerëzve. Disa u janë adaptuar këtyre ndryshimeve shumë mirë duke adaptuar stil evropian modern të jetesës, derisa shumica vazhdojnë të jetojnë në mënyrë tradicionale. Tani ekziston një përzierje e dy stileve ekstreme të jetesës në një kulturë dhe një lokacion. Në Prishtinë dhe qytete të tjera të mëdha në Kosovë ne gjejmë modernizim të të gjitha vlerave jetësore, stilit dhe ritmit të jetesës. Megjithatë, nëpër qytezat e vogla dhe në regjionet rurale të Kosovës ka vende që ende nuk janë prekur nga modernizimi dhe si të tilla mbesin të karakterizuara nga mënyra tradicionale e jetesës. Vija në mes të këtyre dy ekstremeve është shumë e hollë. Çështja është: A dëshiron shoqëria kosovare t'i mbetet besnike mënyrës tradicionale apo dëshiron të modernizohet?

### **MODERNIZIMI DHE VARFËRIA**

Procesi i modernizimit në Kosovë ka filluar gjatë viteve 1970-1980, kur filloi industrializimi, urbanizimi dhe arsimiti formal. Ky proces i solli fund jetës tipike tradicionale dhe familjeve të mëdha patriarkale në Kosovë. Gjatë viteve 1990, pasi që regjimi i Millosheviqit ia hoqi autonominë Kosovës një numër i madh i njerëzve emigruan në shtetet perëndimore (Gjermani, Zvicër,



Skandinavi, ej). Për shumë familje që kishin të ardhura të vogla ose që nuk kishin fare të ardhura dhe që kishin lidhje të forta familjare me familjen jashtë vendit, diaspora u bë burim i të ardhurave. Edhe sot, pas konfliktit të vitit 1999 dhe pas përfundimit të fazës emergjente të rindërtimit, Kosova ende ballafaqohet me varfëri dhe kushte të rënda ekonomike. Sipas Raportit të Zhvillimit Njerëzor (KHDR) 2004<sup>1</sup>, shkalla e papunësisë në vitin 2004 ishte 44 përqind e popullsisë së përgjithshme (39 përqind në mesin e meshkujve dhe 58 përqind në mesin e femrave). Sipas po këtij raporti, 47 përqind e popullsisë jeton në varfëri (me 2 dollarë në ditë për person), derisa 13 përqind jeton në varfëri ekstreme (me 1 dollarë në ditë për person). Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale vlerëson se shkalla e papunësisë për vitin 2006 është 40 përqind e fuqisë së përgjithshme punëtore. Gjithashtu, sipas KHDR-së 2004<sup>2</sup>, madhësia mesatare e ekonomisë familjare në vitin 2004 ka qenë 6.5 anëtarë për ekonomi familjare, përdërisa shkalla e analfabetizmit konsiderohet të jetë 6 përqind (3 përqind për meshkuj dhe 9 përqind për femra) dhe të ardhurat mesatare mujore janë shumë të ulëta (p.sh. 136 Euro për meshkujt dhe 42 Euro për femrat). Kosova ka një popullsi të re, ku 33 përqind janë në 15 vjet.<sup>3</sup>

Shifrat e lartpërmendura tregojnë se femrat kanë një rol shumë të pafavorshëm në shoqëri. Edhe pse institucionet dhe OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare kanë tentuar të përmirësojnë statusin e femrave në shoqëri, numrat tregojnë se pabarazia gjinore ende është e madhe. Kjo ndikon në mundësinë e femrave për të marrë vendime.

Ligji për Barazi Gjinore i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i autorizuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, është aktualisht në fuqi në Kosovë. Megjithatë, nuk ka mënyrë për të vlerësuar se si dhe kur është duke u aplikuar ky ligj në institucione dhe jetën publike në Kosovë. Një shembull i mirë i aplikimit të barazisë gjinore është në mesin e partive politike dhe Kuvendin e Kosovës, ku femrat përmbushin kuotën prej 30 përqind të përfaqësimit. Megjithatë, nëse i shikojmë seancat parlamentare për së afërmi, mund të vërejmë se pjesëmarrja e femrave në debate është mjaft e vogël në krahasim me meshkujt (vetëm duke numëruar se sa herë flasin femrat gjatë një seance). Sipas Studimit Zëri i Grave<sup>4</sup>, femrat ndjejnë se meshkujt ende kanë më shumë të drejta dhe atë të drejta mbi femrat. Prandaj, Ligji për Barazi Gjinore ende nuk aplikohet plotësisht në jetën publike dhe institucionet publike.

Duke marrë parasysh pozitën e femrave në shoqëri, pushimi i lindjes është

problem në Kosovë. Sipas Ligjit për Punë Esenciale në Kosovë<sup>5</sup>, punëtorja femër ka të drejtë për së paku 12 javë pushim të lindjes të paguar, me rastin e lindjes së fëmijës. Ky pushim konsiderohet si periudhë pune dhe duhet të paguhet nga punëdhënësi në shkallë prej jo më pak se dy të tretat e të ardhurave të femrës. Ky është kryesisht rasti në sektorin publik. Në sektorin privat këto rregulla nuk aplikohen në shumicën e rasteve. Nëse femra është e punësuar në sektorin privat dhe martohet, shtatzënia mund ta rrezikojë vendin e saj të punës. Sipas Studimit Zëri i femrave<sup>6</sup>, të gjitha femrat në Kosovë do të preferonin të kenë pushim të lindjes prej 12 muajsh. Nëse një femër që punon në sektorin publik vendos të kthehet në punë pas 3 muajsh dhe angazhon një dado, kjo do t'i kushtonte përafërsisht gati sa rroga mesatare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, që është 213 Euro<sup>7</sup>.

## FAMILJA

Në shoqërinë kosovare, struktura dhe funksioni i familjes ka qenë i përcaktuar kryesisht nga “libri i ligjit” i quajtur “Kanuni i Lekë Dukagjinit”. Ky libër është respektuar nga të gjithë antarët e komunitetit, veçanërisht në zonat rurale dhe ata të cilët nuk i kanë respektuar këto ‘rregulla’ janë ndëshkuar në mënyrë të caktuar. Pjesa më e madhe e kulturës dhe mentalitetit kosovar buron nga këto rregulla. Përpos ndryshimeve kulturore të fundit, disa aspekte të ‘librit të ligjit’ kanë mbetur ose i janë përshtatur rrethanave të sotme.

Familja patriarkale akoma është prezente në Kosovë. Babai ose personi më i vjetër në familje ka rolin kryesor në të gjitha vendimet për të gjithë antarët e familjes. Burri në familje akoma e ka fjalën përfundimtare. Është gati e pamundur t’i kundërvihesh ose të kundërshtosh atë dhe prapë të kesh marrëdhënie të mira me të. Meshkujt kryesisht e furnizojnë familjen me ushqim dhe mjete tjera për jetesë. Rezultatet nga studimi ‘Zëri i Grave’<sup>8</sup> tregojnë që edhe pse gjysma e femrave të intervistuar deklarojnë që vendimet për rritjen e fëmijës merren bashkërisht nga gruaja dhe burri, gjysma e tyre deklarojnë po ashtu se ‘është mirë që në martesë burri dhe gruaja të jenë të barabartë por më së miri është që burri të ketë fjalën e fundit’.

Roli tipik i nënës është t’u ofroj fëmijëve dhe burrit dashuri dhe kujdes duke përfshirë këtu gatimin, pastrimin dhe punët tjera shtëpiake<sup>9</sup>. Sipas studimit ‘Zëri i Grave’<sup>10</sup>, 64 përqind e femrave me 1-4 vite shkollim “pajtohen plotësisht” me deklaratën që “shumica e punëve të shtëpisë janë natyrisht punë të gruas” përdërisa 28 përqind e femrave me më shumë se 13 vjet shkollim pajtohen plotësisht me këtë deklaratë. Sipas “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, burri i familjes ka gjithë drejtën dhe është i detyruar të marrë vendime përdërisa gru-



aja ka të drejtë “vetëm të kërkoj ushqim dhe veshmbathje” nga burri i saj<sup>11</sup>. Në shumë familje, kjo është akoma ligj dhe femra trajtohet si shërbëtoare e familjes.

Duke pasur parasysh kushtet e vështira ekonomike me të cilat njerëzit po përballen sot, shumica e anëtarëve të familjes janë të angazhuar për të gjetur punë. Si rezultat, disa femra gjejnë pune, sidomos në zonat urbane. Gratë e punësuar bëhen furnizues të ushqimit dhe nevojave tjera për familjet e tyre dhe respektohen më shumë për shkak të kontributit të tyre ekonomik. Familjet bëhen ekonomikisht të varura nga gruaja e punësuar e cila gjë e forcon zërin e tyre për vendim marrje në familje. Kjo është një ndër arsyet pse lloji dhe struktura e familjes kanë ndryshuar prej familjes tipike patriarkale në familje më moderne sa i përket barazisë gjinore.

Vetëdijesimi që fëmijët kanë të drejta është duke u përhapur paralel me edukimin (Konventa e të drejtave të fëmijëve është e përfshirë në tekste shkollore). Sipas studimit të bërë nga UNICEF “Rinia në Kosovë”<sup>12</sup>, më shumë se 50 përqind e të rinjve deklarojnë që zërat e tyre dëgjohen “shumë” në vendimmarrje të rëndësishme në familje. Sidoqoftë, të drejtat e fëmijëve akoma abuzohen. Në çfarëdo kohe në rrugë fëmijët shesin cigare, çamçakëzë dhe kikirika. Edhe pse nuk ka ndonjë studim të bërë, OJQ-të që merren me avokimin e të drejtave të nënës dhe fëmijëve deklarojnë që ka shumë raporte të dhunës dhe abuzimit të fëmijëve.

## **NDRYSHIMET NË JETËT E GRAVE**

Që nga konflikti i vitit 1999, gjërat kanë ndryshuar në mënyrë drastike në Kosovë. Ekonomia familjare tipike e përbërë nga tre vëllezër, të gjithë të martuar dhe me fëmijë që gjithsejtë përbënin pesëmbëdhjetë anëtar të familjes, tani më janë ndarë dhe kanë filluar jetesën veçmas. Si rezultat, femrat kanë rolin e tyre në ekonomi më të vogël familjare dhe marrin pjesë në vendim marrje.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë që meshkujt filluan të ndihmojnë rreth punëve të shtëpisë, veçanërisht në raste të veçanta siç janë shtatzënia e gruas ose sëmundjet e kohëpaskohshme të ndonjë anëtari të familjes. Njerëzit filluan të vlerësojnë familjen e tyre ndryshe dhe të respektojnë të drejtën e tyre për të zgjedhur çfarë është më e mira për ta.

Shumica e pjesëmarrësve në studim besojnë se ndryshimet në shoqëri e veçanërisht marrëdhëniet në mes të burrit dhe gruas kanë ndryshuar me

vetëdijesimin e grave për të drejtat e tyre dhe përdorimin e këtyre të drejtave për përmirësimin e jetesës së tyre. Po ashtu liria e lëvizjes së grave ka ndryshuar. Sipas disa pjesëmarrësve në studim, femrat nuk janë lejuar të dalin vetë për shkak se ‘njerëzit flasin’. Tani, më shumë e më shumë gra ndjehen të lira të dalin, blejnë gjëra dhe bëjnë çfarëdo që kanë nevojë. Fatkeqësisht kjo gjë nuk aplikohet gjithkund. Akoma raportohen raste ku familja nuk e lejon femrën e shtëpisë të dal vetëm ose për shkak të shprehisë që femrat duhet të jenë të përcjellura gjatë gjithë kohës, disa femra as që ndjehen rehat ose të sig-urta që të dalin vetëm.

Pjesëmarrësit në studim besojnë po ashtu që zhvillimi i teknologjisë e ka lehtësuar dukshëm jetën e femrave në Kosovë. Kushtet e jetesës kanë qenë shumë më të vështira në të kaluarën. Femrat ishin të obliguara të bënin punët e shtëpisë, punonin në fushë, të kujdesen për fëmijë dhe të pastrojnë krejtësisht vetë. Deri vonë, e veçanërisht në zonat rurale, nuk ka pasur makina për larjen e rrobave ose sistem të ujit brenda në shtëpi. Femrat duhej të bënin të gjitha punët me dorë. Shumica e pjesëmarrësve në studim deklarojnë se jeta e tyre është dukshëm më e lehtë dhe më e mirë se që ka qenë jeta e nënave të tyre. Tani femrat janë më të respektuara dhe trajtohen më mirë se më parë, veçanërisht në zonat rurale.

## **MARRËDHËNIET RECIPROKE**

Mungesa e psikologëve nuk është vetëm rastësi në shoqërinë Kosovare. Në shoqërinë kosovare marrëdhëniet në komunitet janë shumë të forta, të gjithë e njohin njëri tjetrin dhe të gjithë i dinë punët e njëri tjetrit, e edhe ato çështje intime. Njerëzit janë shumë të lidhur me njëri tjetrin dhe kalojnë shumë kohë së bashku, kryesisht duke diskutuar problemet e tyre personale.

Rezultatet e studimit nxjerrin se femrat kryesisht bisedojnë me shoqe të ngushta, disa bisedojnë edhe me nënat ndërsa disa janë plotësisht të hapura ndaj partnerëve të tyre. Disa gjejnë shoqe të ngushtë me probleme të njëjta. Problemet e përditshme diskutohen rregullisht çdo ditë pa hezitim përderisa problemet intime, ato me partnerët, nuk ndahen lehtë me të tjerët.

Disa femra hezitojnë t’i ndajnë problemet e tyre me nënat e tyre për arsye të ndryshme. Sipas disa pjesëmarrësve, nënat mund të gjykojnë sjelljet dhe veprat e tyre, ose edhe mund të lëndohen. Në anën tjetër, shoqet mund të tradhetojnë ndonjëherë dhe të nxjerrin në pah sekretin e tyre.



Burrat konsiderohen të jenë partnerët më të besueshëm për biseda. Megjithatë, sipas pjesëmarrëseve në diskutim, burrat nuk janë gjithmonë të interesuar të dëgjojnë për ndjenjat dhe mendimet e tyre.

Çështjet dhe temat e seksualitetit diskutohen në tallje. Gjatë bisedave për seksin në diskutim në grup, disa pjesëmarrëse nuk ndjeheshin rehat. Kishte dallime në mes të femrave që jetonin në zonat urbane dhe atyre që jetonin në zonat rurale sa i përket kësaj çështje. Femrat kosovare – serbe dhe femrat që jetojnë në Prishtinë ishin më të hapura në bisedat për seksualitetin sesa femrat tjera.

*“Intervistuesi: A bisedoni me dikë për marrëdhënie seksuale?”*

*Respondenti: Vetëm kur tallemi, por jo edhe kur flasim seriozisht.”*

**Femër, 26-45, Prishtinë, rural, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

Femrat e martuara, përpos kosovaret serbe dhe femrat që jetojnë në Prishtinë, turpëroheshin kur flasin për probleme të ndjeshme seksuale me dikë tjetër përpos burrit të tyre.

*“Intervistuesi: A janë marrëdhëniet seksuale ose çështjet intime diçka për të cilat diskutoni me të tjerët?”*

*Respondenti: Vetëm me burrin tim ... Është marre të fliten këto gjëra me dikë tjetër.”*

**Femër, 15-45, Prizren, rural, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)**

Edhe pse njerëzit në Kosovë janë shumë të afërm me njëri tjetrin, kalojnë shumë kohë bashkë dhe ndajnë gjithçka me njëri tjetrin e veçanërisht femrat, në të shumtën e rasteve seksualiteti është diçka që njerëzit rrallë ose kurrë nuk flasin. Veç kësaj, në kanalet televizive nuk ka programe edukative për edukatën seksuale që do t'i përfshinin njerëz të moshave të ndryshme.

## **MENDIMET PËR SEKSIN PARAMARTESOR**

Në Kosovën e re pas konfliktit, ka ndryshime në marrëdhëniet gjinore tek gjeneratat e reja (p.sh. veçanërisht liberalizimi i seksit dhe aplikimi i seksit paramartesor tek të rinjtë në zonat urbane). Bukuria fizike, imixhi, trendi, sjelljet liberale dhe kënaqësia personale janë bërë vlera dominuese të seksualitetit. Virgjiniteti, origjina familjare dhe nderi janë vlera të cilave po ju bjen rëndësia sipas pjesëmarrëseve në studim.

Mendimet e pjesëmarrëseve në studim për seksin paramartesor kanë ndikuar



fuqimisht mendimet mbi abortin në mesin e femrave të pa martuara siç shpjegohet në kaptinën 2.

Virgjiniteti i femrës konsiderohet të jetë pjesa më e rëndësishme e moralit, dinjitetit dhe femrës si tërësi sipas pjesëmarrësve në studim. Në disa zona, nëse nusja nuk e tregon çarçafin pas natës së parë me burrin e saj që dëshmon që është e virgjër, ajo kthehet te babai i saj për ndonjë ndëshkim të mundshëm. Martesa përfundon menjëherë.

Edhe pse takimet dashurie janë bërë të zakonshme dhe shumica e njerëzve e madje edhe prindërit e pranojnë, nga diskutimet në grup raportohet që seksi paramartesor akoma është i 'ndaluar'. Femra frikësohet nga mundësia e pandershmërisë nga ana e prindërve të saj. Femrat i frikohen mundësisë së tradhëtisë nga ana e partnerëve të tyre pas seksit paramartesor, duke u bren-gosur se meshkujt mund t'i lënë ato dhe të kenë marrëdhënie seksuale me femra të tjera edhe nëse ato mbeten shtatzënë.

*“Sot nuk është në rregull të kesh marrëdhënie seksuale para martese sepse meshkujt sillen si kafshë. Nuk mund t'ju besohet sepse të lënë shtatzënë dhe të braktisin duke të lënë vetëm për tu përkujdesur për fëmijën. Duke mos ditur çfarë të bëjnë ose kujt t'i drejtohen, femrat çlirohen nga fëmijët duke i lënë foshnjat në rrugë.”*

**Femër, 26-45, Prishtinë, urban, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

Edhe pse pjesëmarrësit deklarojnë se virgjiniteti nuk është çështje më, shumica e pjesëmarrësve, veçanërisht në zonat rurale, deklarojnë që së paku për meshkujt dhe djemtë e tyre, virgjiniteti është akoma çështje kryesore që duhet të konsiderohet para martesës.

Frika nga të qenit e braktisur nga i dashuri pasi që ai të ketë përmbushur nevojat e tij seksuale është shumë e pranishme dhe e përhapur. Mund të ketë bazë për këtë brengë pasi që edhe meshkujt në studim pranojnë se nuk do të mar-toheshin me një femër me të cilën do të kishin marrëdhënie seksuale para fejesës.

*“Nuk do të martohesha me një femër me të cilën do të kisha seks paramartesor.”*

**Mashkull, 26-45, Prizren, rural, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)**

Të gjithë meshkujt mbështesin seksin paramartesor. Disa besojnë që seksi lejon kuptimin e plotë të femrës përdërisa të tjerët deklarojnë se seksi para-



martesor është përvojë e mirë. Në mënyrë paradoksale, meshkujt deklarojnë se nuk do të martoheshin me një femër që nuk është e virgjër.

*“Kam dëgjuar meshkujt që kanë marrëdhënie seksuale me shumë femra të thonë që duan që gruaja e tyre të jetë e virgjër. Kjo nuk është në rregull.”*

**Mashkull, 15-25, Prishtinë, urban, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)**

Veçanërisht në zonat rurale, virgjiniteti i femrës është i rëndësishëm. Megjithatë, seksi paramartesorë sipas pjesëmarrësve në fokus grup gjithashtu ka pasoja tjera. Në zonat urbane, shtatzënia e padëshiruar duket të jetë frika më e shpeshtë dhe pasojë e seksit paramartesor.

*“Mentaliteti këtu në Kosovë nuk na lejon ta mbajmë fëmijën, edhe nëse i ke kushtet më të mirat jo për ta rritur një fëmijë por edhe dy ose për ta mbajtur krejt familjen, nuk ka rëndësi, shoqëria nuk ta lejon, dhe nuk mund të rrisësh fëmijë vetëm. Fëmija do të etiketohet dhe gjithë jetën do të thirret kopil. Kurrë nuk kam dëgjuar që femra ose një studente ka arritur të rrisë fëmijën vetëm pa burrë.”*

**Femër, 15-25, Prishtinë, urban, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

Rezultatet nga diskutimet në grup nxjerrin se rreziku tjetër i seksit paramartesor janë edhe sëmundjet dhe infeksionet e ndryshme.

*“Normalisht, nëse nuk di si të kontrollohesh, pasojat janë aq të mëdha sa që do të harrosh virgjinitetin. Janë përhapur sëmundje të ndryshme. Rreziku tjetër është shtatzënia, nëse ai nuk e pranon fëmijën atëherë çfarë të bëhet. Familja nuk do ta pranoj. Është ndryshe nëse e ke bërë me qëllim, por nëse të ndodhë pa dashje, atëherë nuk ki kujt t'i drejtohesh sepse askush nuk do të kuptoj, do të thonë lëre. Ka pasoja shumë të mëdha nëse vjen puna deri aty.*

**Femër, 15-25, Mitrovica, rural, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

Çuditërisht, shumica e femrave serbe të Kosovës dhe femrat urbane nga Prishtina që morën pjesë në studim mendojnë që seksi paramartesor është i zakonshëm në ditët e sotme, sidomos është e natyrshme të kesh marrëdhënie seksuale me dikë që ke qenë një kohë të gjatë.

*“E gjitha varet nga personi. Nëse dy të rinj duhen dhe ndjejnë se mund të jetë përgjithmonë bashkë, ata mund të kenë marrëdhënie*

*edhe para martesës.”*

***Femër, 15-25, Çagllavicë, rural, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)***

Megjithatë, femrat theksuan çështjen e përdorimit të kontraktivëve gjatë marrëdhënieve seksuale para martesës në mënyrë që të evitohen pasojat e padëshiruara. Ato potencuan edhe rëndësinë e pjekurisë fizike dhe psikologjike.

*“Nuk jam kundër seksit paramartesor. Gjëja e vetme dhe më e rëndësishme është që femra të jetë e pjekur fizikisht dhe psikikisht. Megjithatë, kontraktivët janë të rëndësishëm në këtë pikë. Do të veçoja këtu mbrojtjes kundër shtatzënisë dhe sëmundjeve seksuale”*

***Femër, 26-45, Çagllavicë, rural, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)***

Në përgjithësi kosovaret serbe dhe femrat urbane në Prishtinë haptas pranojnë që kishin dhe kanë marrëdhënie seksuale paramartesore. Disa bashkëjtonin me partnerët e tyre ndërsa disa tjera mendojnë që kjo është turp dhe keq.

## **ORIENTIMI SEKSUAL SI ÇËSHTJE**

Përderisa mendimet për seksin paramartesor mund të kenë ndryshuar, veçanërisht në zonat urbane, mendimet për orientimet tjera seksuale nuk kanë ndryshuar. Rezultatet e diskutimeve në grup ilustronë mosgatishmërinë për të pranuar homoseksualitetin. Në kuptimin e pranimi të zhvillimeve të ‘reja’ në shoqëri, pjesëmarrësit tregohen mjaftë konservativ. Disa pjesëmarrës ishin më mendje hapur përderisa shumica e refuzonin paramendimin e të qenurit afër një mashkulli ose femre homoseksuale. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në diskutime në grup ndanin të njëjtin mendim se homoseksualët janë dhe do të jenë të diskriminuar nga shoqëria. Sipas pjesëmarrësve, shoqëria jonë është shumë e vogël dhe konservative dhe nuk do të pranonte ndryshime të cilat nuk janë ‘normale’ ose siç i quanin ‘absurde’. Shoqëria kosovare sipas disa pjesëmarrësve ka mjaftë ngarkesa tjera edhe pa këtë çështje; pranimi i kësaj çështjeje do të ishte e tepërt për shoqërinë kosovare në këtë moment.

Pjesëmarrësit ndjejnë se është shumë e vështirë për homoseksualët të jetojnë në Kosovë. Në përgjithësi, është shumë e vështirë të mbijetohet edhe për ata që shikohen si të barabartë sepse Kosova është e vogël dhe provinciale.

*“Nëse fqinji im do të ishte homoseksual – sigurisht që do të distancoheshim ne dhe fëmijët prej tij/saj, megjithëse raste të tilla nuk ka në*



*Prizren.”*

*Femër, 26-45, Prizren, urban, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)*

## **PERCEPTIMET PËR SHTATZËNINË DHE KUJDESIN PARA LINDJES**

Kujdesi para lindjes është kujdesi që merr dhe jap femra për veten gjatë shtatzënisë. Kosova është vend ku kujdesi para lindjes nuk është në të njëjtin standard si në shtetet tjera i ofruar nga shërbimet shëndetësore qeveritare. Kjo mungesë e theksimit të kujdesit gjatë shtatzënisë për femrën dhe fetusin ndikon në atë se si perceptohet shtatzënia në shoqëri dhe si është e lidhur me abortin, siç shpjegohet në Kaptinën 3.

Edhe pse disa pjesëmarrës në fokus grupe nuk ishin të njoftuar me termin ‘kujdesi para lindjes’, të gjithë e dinin për çfarë është fjala. Rezultatet e fokus grupeve tregojnë që të gjitha aspektet e kujdesit para lindjes duke përfshirë këtu shërbimet mjekësore nga mjekët, kujdesi i familjes për gruan shtatzënë dhe kujdesi i vetë nënës janë përmirësuar dukshëm. Edhe qëndrimi i shoqërisë lidhur me rolin dhe rëndësinë e femrës dhe shtatzënisë ka ndryshuar. Megjithatë, gati të gjithë pjesëmarrësit pajtohen që akoma ka hapësirë për përmirësime, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve dhe në edukimin e nënave gjatë shtatzënisë.

### **Mbështetja Familjare**

Femra shtatzënë shihet si e ndjeshme dhe të gjithë pjesëtarët e familjes së saj janë më të kujdesshëm. Ajo po ashtu fiton më shumë respekt. Femrat gjatë shtatzënisë marrin më shumë ndihmë nga të gjithë anëtarët e familjes, veçanërisht nga burri. Femrat lirohen nga punët e vështira të shtëpisë (mbajtja e gjërave të rënda, ngjitja në shkallë). Pjesëmarrësit raportojnë se femrat lirohen edhe prej stresseve gjatë shtatzënisë.

*“Epo, t’ju them të vërteten, gjatë shtatzënisë se parë isha më e kujdesshme, por gjithashtu edhe burri dhe familja sepse isha shumë e re dhe në atë kohë nuk e dija se çfarë mund dhe çfarë nuk mund të bëja. Për shembull, kur hipja shkallëve ata më thonin të zbrisja sepse nuk është sigurt për mua të ngjitem lartë. Por pas një viti ngela prapë shtatzënë dhe pasi që djali im ishte vetëm nëntë muajsh gjërat në kokë i kisha akoma të freskëta dhe nuk kisha problem më gjatë shtatzënisë e as gjatë lindjes. Familja më kushtonte më pak rëndësi sepse nuk ishte e nevojshme sepse i kisha mësuar gjërat nga shtatzënia ime e*

*parë”.*

***Femër, 15-45, Mitrovicë, urban, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)***

Femrat më të vjetra deklarojnë se kur ishin shtatzënë, vite më parë, kujdesi nga anëtarët e familjes ishte më i vogël. Ata jetonin në familje shumë të mëdha me vëllezërit e burrit dhe familjet e tyre kështu që kishte shumë punë që duhej të bëheshin rreth shtëpisë. Femrat lindnin fëmijë më shpesh dhe punët duhej përfunduar pa marrë parasysh nëse femrat ishin shtatzënë ose jo. Askush nuk pyeste nëse femra ndjehej mirë ose nëse ishte në gjendje të punonte ose jo; thjeshtë gjërat duhet të kryheshin. Megjithatë, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit deklaruan që shtatzënia ka qenë gjithmonë e respektuar në kulturën kosovare; trajtimi nga familjet e tyre ka qenë gjithmonë më i mirë kur ato ishin shtatzëna.

Gjinekologët konfirmojnë se që nga konflikti i vitit 1999, familjet, veçanërisht burrat kanë treguar interes më të madh për kujdesin dhe gjendjen shëndetësore të grave shtatzëna rreth tyre.

*“Femrat shtatzëna përgjithësisht trajtohen më mirë nga familjet e tyre tani.”*

***Gjinekolog, Prishtinë, urban, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)***

*“Kur punoja në Spitalin e Gjakovës vëreja një gjë interesante: shumë burra i sjellin gratë e tyre për shërim në spital për javë të tëra në mënyrë që t’ju siguronin pushim atyre dhe t’ju thonë familjeve të tyre që mjeku e ka rekomanduar pushimin! Kjo ndodhë veçanërisht në familjet e mëdha dhe ku gruaja nuk mund të ketë pushim sepse i duhet të punoj. Në këtë mënyrë ato pushojnë që në raste tjera nuk do të mundnin!”*

***Gjinekolog, Prishtinë, urban, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)***

## **Kujdesi paralindjes**

Rezultatet nga fokus grupet tregojnë se femrat janë më të vetëdijshme tani për rëndësinë e shtatzënive të tyre. Tani është ndryshe të jesh shtatzënë në Kosovë. Ushqimi është një ndër prioritetet për të cilin shumica e femrave kujdesen. Shumica e femrave shtatzëna sot nuk hezitojnë dhe nuk turpërohen të vendosin shëndetin e tyre dhe të fëmijës së tyre në rend të parë. Ato ndjehen të lira dhe dinë se si të kujdesen për vetën më shumë se sa femrat shtatzëna vite më herët.



*“Nëna ime ka punuar edhe pse ishte shtatzënë. Dhe femrat shtatzëne sot thonë: jam shtatzëne, fëmija im duhet të jetë i shëndoshë, që do të thotë se unë duhet të ushqehem mirë, të pushoj, dhe të mos e ngarkoj vetën. Familja rreth saj nuk lejohet që ta mërzis sepse secili kanë frikë se, larg qoftë, nëse i ndodhë diçka, ata do të mbesin fajtorë.”*  
**Femër, 15-25, Gracanica, rural, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)**

Gjinekologët deklarojnë se femrat janë gjithmonë të sakta për kontrollet e tyre rutinore dhe i kushtojnë shumë vëmendje se çfarë ju thotë mjeku. Gjinekologët po ashtu theksojnë se femrat tani janë shumë më të interesuara në zhvillimin dhe mirëqenien e fetusit të tyre krahasuar me më herret.

### **Shërbimet para lindjes**

Sipas gjinekologëve, shërbimet për kujdesin mjekësor para lindjes janë përmirësuar si në nivel publik po ashtu edhe në at privat. Megjithatë, në të dy vendet ku jepet ky shërbim, është evidente mungesa e shpjegimit dhe këshillimit. Mjekët e pranojnë se nuk mund ti kushtohen plotësisht pacientit për shkak të mungesës së kohës. Në ordinanca publike mjeku kalon 5-10 minuta me pacientin përderisa jashtë dhomës janë edhe 10 femra tjera që presin të kontrollohen.

Sipas disa femrave, shumë femra shkojnë në Shkup, Maqedoni për kontrolle mjekësore dhe për lindje. Mjekët deklarojnë se diagnoza në esencë është e njëjtë por që mjekët atje e shpjegojnë me më shumë detaje procesin e lindjes së foshnjës. Ata e diskutojnë edhe pozitën e fetusit. Mjekët në Prishtinë, si në ordinanca publike po ashtu edhe në ato private thjeshtë nuk kanë kohë. Megjithatë, disa gjinekolog deklarojnë se femrat nuk janë të interesuara të dëgjojnë këshilla për kujdesin gjatë shtatzënisë së tyre.

*“Informimi i femrës për gjendjen e saj është po ashtu i rëndësishëm. P.sh., femra shtatzëne 37 vjeçare është vizituar disa herë prej një gjinekologu shumë të mirë në Kosovë. Gjinekologu i ka thënë gruas se shtatzënia e saj po zhvillohet mirë dhe kjo ishte e tëra. Që të dy shkuam në Shkup për të vizituar gjinekologun dhe e vërejtja se gjinekologu ishte shumë i durueshëm. Ai i shpjegoi gruas gjithçka që ajo kishte nevojë të dinte duke përfshirë edhe pozitën e bebes. Ai shpjegoi gjithçka gati gjysmë ore! Kjo është ajo që nuk e bëjnë mjekët tonë! Thjeshtë nuk i informojnë pacientët e tyre!”*

**Gjinekolog, Prishtinë, urban, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)**

*“Ne japim shpjegime për shtatzëni por shumë pak femra janë në të vërtetë të interesuara t’i dëgjojnë. Është një përqindje shumë e madhe e femrave që na injorojnë kur ne ju japim shpjegime! Dhe kjo është arsyeja pse ne i ri-trajtojmë. Siç duket mungesa e komunikimit në mes të mjekut dhe pacientit ndodhë për shkak të traditës tonë. Zakonisht femrat më të vjetra nuk flasin me ne edhe pse ne jemi në dispozicionin e tyre. Ka disa që janë të interesuara dhe pyesin për informacione shtesë!”*

***Gjinekolog, Prishtinë, urban, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)***

Femrat shprehen deri diku të kënaqura me shërbimet. Shumica prej tyre besojnë se të shkuarit në ambulantë publike pa e njohur ndonjë mjek atje është katastrofë. Mund të ndodhë të presësh me orë të tëra dhe në fund mjeku nuk të përkushtohet.

Sipas pjesëmarrëseve në fokus grup, ordinancat private preferohen më shumë nga femrat. Kujdesi është plotësisht ndryshe në ordinanca private sepse paguan për vizitë dhe mjeku është më i kujdesshëm. Tarifa për kontrolle të rregullta konsiderohet të jetë shumë e shtrenjtë. Për vizitat e shpeshta që nevojiten gjatë shtatzënisë, çmimet mund të jenë të papërballeshme për disa.







## KAPITULLI 2 ABORTI I NXITUR

Aborti ka histori të gjatë në Kosovë. Vlerësimet e UNFPA (2000) tregojnë se 4.8 aborte bëhen në 100 lindje. Megjithatë, këto vlerësime konsiderohen si të ulëta pasi që studimi ishte i bazuar në deklaratat dëshmuese. Nga të dhënat e mbledhura në spital në vitin 2002 (UNFPA) doli që kishte 5 aborte në 100 lindje. Megjithatë, këto të dhëna nuk janë të plota pasi që përfaqësojnë vetëm rastet në spitalin e përgjithshëm. Besohet se një numër i madh i aborteve të pa dokumentuara bëhen në klinika private.

Ligji mbi abortin në Kosovë akoma nuk është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, aborti është legal qysh para konfliktit në vitin 1999 (kur Kosova nuk kishte autonomi dhe ligjet e Serbisë ishin në funksion). Sipas ligjit të Serbisë mbi Ndërprerjen e Shtatzënisë “aborti duhet të bëhet me kërkesën e gruas, dhe të aplikohet nëse shtatzënia është më pak se 10 javë. Nuk nevojitet miratimi i nënshkruar dhe nuk ka nevojë të pritët; miratimi i prindit kërkohet për të miturit nën moshën 16 vjeçare”. Sipas raportit mbi Shëndetin dhe Kujdesin shëndetësor në Kosovë (Ministria e Shëndetësisë, 2004) ka raportime të pa dokumentuara që klinikat private bëjnë aborte madje edhe pas javës së 10 të shtatzënisë.

Përdorimi i kontraktivëve është ‘alarmant’ i ulët në Kosovë. Sipas vlerësimeve të UNFPA (UNFPA, DHS- 2003), 35 përqind e femrave të



moshës reproduktive përdorin kontraceptivë, 14.5 përqind përdorin metoda moderne (kryesisht spiralë 7 përqind dhe pilula dhe prezervativë 3 përqind). Metodat tradicionale janë më të përdorura (21 përqind), gati 20 përqind përdorin metodën e nxjerrjes. (shih për më tepër Kapitullin 4).

## **PERCEPTIMET PËR ABORTIN: DISA DALLIME**

Aborti perceptohet si diçka që është i ‘msheftë’. Kryesisht perceptohet si fenomen negativ, por ndonjëherë si diçka e nevojshme e në disa raste e pashmangshme.

Varësisht nga këndvështrimi, regjioni dhe mosha e femrave, mendimet e femrave për abortin ndryshojnë. Disa femra arsyetojnë ato që kanë pasur abort përderisa tjerat e refuzojnë kategorikisht idenë e abortit.

Është e rëndësishme të merren parasysh arsyet për abort kur provohet të matet shkalla e pranimit të abortit. Ndërprerja e shtatzënisë për shkaqe shëndetësore, zhvillimit jonormal të fetusit dhe në disa raste edhe dhunimi seksual, në përgjithësi janë të pranueshme nga pjesëmarrësit. Megjithatë, disa pjesëmarrës e konsideronin abortin dhe arsyet pse vjen deri te aborti si të ‘pakuqimtare’.

Kur krahasohen rezultatet e studimit mbi mendimet për abortin, femrat nga Prishtina veçohen nga femrat e të gjitha vendeve tjera në mostrën me Shqiptare. Femrat që jetojnë në Prishtinë besojnë që aborti duhet të ekzistoj si opsion, veçanërisht kur merret parasysh gjendja e vështirë financiare. Sipas disa prej tyre, nëse aborti nuk do të ekzistonte si opsion, varfëria do të pësonte rritje në mënyrë drastike. Kur ato e përfytyronin vetën në situata të ndryshme, shumica prej tyre pajtoheshin që aborti duhet të ekzistojë si opsion.

Femrat që jetojnë në zona urbane në përgjithësi e konsiderojnë abortin si normal kur arsyeja për abort është e vlefshme. Edhe pse ato nuk do të dëshironin të kenë abort, e pranojnë abortin si diçka që duhet të bëhet.

*“Ne i përkasim kësaj shoqërie, dhe dihet që kushtet ekonomike nuk janë aq të mira, dhe kjo është arsyeja pse unë do të abortoja. Jam studente, nuk punoj dhe nuk kam mundësi të kujdesem për veten e lere më për fëmijën. Nëse kjo do të ndodhte, nuk do të kishte më çfarë të diskutohej, nuk do të kisha zgjedhje tjetër”.*

***Femër, 15-25, Prishtinë, urban, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)***

Përderisa shumica e femrave nga Prishtina deklarojnë që aborti nuk është gjë e mirë por duhet të jetë opsion, femrat e zonave tjera urbane siç janë Prizreni dhe Mitrovica në mostrën me Shqiptarë menduan ndryshe. Këtu, femrat më të vjetra kryesisht ishin kundër abortit; megjithatë ato besonin se nëse ka arsye të fortë, femrat duhet të lejohen të kenë abort. Çuditërisht, gjeneratat më të reja ishin më të vendosura në mendimet e tyre që aborti nuk dihet të jetë i pranishëm në shoqërinë tonë. Sipas tyre, aborti është krim.

*“Shyqyr Zot që nëna ime nuk ka pasur aborte përndryshe ndoshta do ta shihja ndryshe. Ka shumë kriminel që kanë kryer krime, ne i shohim me një sy tjetër dhe ata janë në burg tani përderisa disa abortojnë shtatë fëmijë dhe janë në shtëpitë e tyre, si asgjë mos me pas ndodhë.”*

**Femër, 15-25, Prizren, urban, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

Femrat që jetonin në zonat urbane nuk hezitonin të flisnin për eksperiencën e tyre me aborte përderisa femrat në zonat rurale ishin më konservative. Situata është shumë e ngjashme edhe në mesin e femrave Kosovare Serbe. Ato besojnë që aborti është mëkat dhe se është çështje e moralit nëse aborton, kështu që ato hezitojnë të diskutojnë, veçanërisht kur janë në prani të femrave që i njohin. “Turpi” po ashtu është përdorur për të përshkruar femrat që kanë pasur abort. Edhe tek femrat e martuara dhe tek të pamartuarat aborti nuk është temë për të cilën femrat janë të hapura të flasin. Përkundrazi, shumica prej tyre e fshehin faktin ose përdorin mekanizma mbrojtës për të arsyetuar sjelljet e tyre.

Sipas vëzhgimit të moderatorit të fokus grupeve, nën-vetëdije, aborti perceptohet ndryshe për femrat e martuara dhe të pamartuara. Disa femra më të vjetra janë më të brengosura nëse femra që ka pasur abort është e martuar ose jo. Nëse është e martuar, ka pasur marrdhënie seksuale dhe ka ngelur shtatzënë me burrin e saj, abortimi nuk konsiderohet edhe aq çështje e rëndësishme. Por, nëse kjo i ndodhë një vajze të re, kjo çështje konsiderohet të jetë tabu – të gjithë e dinë për të por askush nuk flet lehtë për të.

Nga aspekti religjioz, si për Myslimanët po ashtu edhe për të Krishterët, aborti është i ndaluar kategorikisht. Shumica e pjesëmarrësve në studim e përshkruajnë abortin si mëkat; mbi të gjitha të gjithë kanë fatin e tyre.

Megjithatë, disa e veçanërisht ato femra që kanë pasur abort, deklarojnë se mëkat më i madh është nëse e mbanë fëmijën dhe vendos ta risësh në varfëri. Disa tjera deklarojnë se nuk është mëkat nëse e aborton fetusin para muajit të



tretë të shtatzënisë por pas kësaj kohe konsiderohet si mëkat. Disa vendosin nëse aborti është mëkat ose jo në bazë të arsyeve për të.

*“Femrat që abortojnë vetëm pse kanë shumë vajza nuk është në rregull sepse fëmija është dhuratë nga Zoti pa marrë parasysh nëse është vajzë apo djalë”*

*Femër, 15-45, Prizren, rural, RAE e Kos. (Intervistë e thellë)*

## **ARSYET PËR ABORT – METODA TË PLANIFIKIMIT FAMILJAR?**

Pjesëmarrësit në studim janë pyetur se cilat rrethana mund të shtyjnë femrën të ndërpres shtatzëninë. Nga rezultatet e fokus grupeve si dhe intervistave të thella, pjesëmarrësit bëjnë dallime në mes të femrave të martuara dhe të pamartuara.

### **Arsyet financiare**

Sipas KHDR 2004<sup>13</sup> shkalla e papunësisë në vitin 2004 ishte 44 përqind e popullatës së përgjithshme (39 përqind tek meshkujt dhe 58 përqind tek femrat); përderisa Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale vlerësoi se shkalla e papunësisë për vitin 2006 ishte 40 përqind e klasës punëtore. Si rezultat, aborti mund të jetë zgjidhje më e lehtë sesa rritja edhe e një fëmije.

Në rastin e femrave të *martuara*, rrethanat financiare dhe numri i shtatzënive u përmendën si arsyt më të shpeshta për abort. Duke pasur parasysh madhësinë mesatare të ekonomisë familjare (2004) që është 6.5 anëtarë për familje<sup>14</sup>, dhe të ardhurat e ulëta, njerëzit vlerësojnë që është më lirë të abortosh sesa të risësh edhe një fëmijë.

Kostoja e ulët e abortit kontribuon në këtë çështje (nga 60 € deri në 100 €, varësisht nëse bëhet në klinikë private apo në spital). Njerëzit arrijnë të gjejnë të holla për abort, duke kërkuar ndihmë nga miqtë ose shokët ose duke shpenzuar kursimet e tyre.

Kushtet financiare luajnë rol të rëndësishëm në vendimin për abort.

*“Kunetërit e mijë ishin të gjithë në shtetet e jashtme dhe kisha frikë se nuk do të mund të rrisja fëmijën në mënyrë të duhur, ose të ofroja kushte të mira për të tre fëmijët e mijë.”*

*Femër, 15-45, Prishtinë, rural, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)*

*“Abortova në vitin 1997. E bëra vet pa më detyruar askush. Në atë kohë ishim në luftë dhe të papunë (unë dhe burri im),kështu që frika që nuk do të jem në gjendje të rris fëmijën në një ambient të mirë, më detyroi të zgjedh abortin...”*

*Femër, 15-45,Prishtinë, rural, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)*

## **Kompleksi i Gjyshes**

Femrat kosovare, veçanërisht më herët, martoheshin shumë të reja; shumica e nënave janë akoma fertile edhe kur fëmija i tyre më i madh është 25 vjeç. Si rezultat, e sidomos në zonat rurale, vjehrra dhe nusja mund të jenë shtatzëna në të njëjtën kohë. Femrat deklarojnë që është shumë e papërshtatshme të presësh fëmijë kur edhe fëmija yt është martuar ose gati të martohet.

## **Zgjedhja e Gjinisë**

Prezantimi i ultrazërit dhe amniocentezës u ka dhënë prindërve mundësinë e zgjedhjes së gjinisë së fetusit para se të lind. Si rezultat, njerëzit kanë edhe një mundësi të zgjedhin dhe vendosin nëse donë të kenë djalë apo vajzë dhe më pas të vendosin të abortojnë nëse gjinia e fetusit nuk është ajo e dëshiruara.

Në traditën Kosovare, djemtë kanë rol më të rëndësishëm në familje sipas pjesëmarrësve në fokus grupe. Djemtë janë prioriteti dhe nderi i familjes. Ata janë pasardhësit dhe nderi i familjes. Ata janë trashëguesit e emrit të familjes dhe në shumicën e rasteve e gjithë pasuria e familjes i lihet djalit – djemve. Vajzat konsiderohen si ‘persona të huaj’ pasi që ato do të martohen dhe të jenë gratë e dikujt dhe jo më pjesë e asaj familje. Si nuse që janë, nga ato pritet të bëjnë fëmijë. Pas vajzës së dytë që lind, anëtarët e familjes zakonisht fillojnë të brengosen nëse do të kenë djalë/nip. Femrës i bëhet presion të bëjë djalë. Duke pasur parasysh se kjo çështje nuk varet nga ajo, ajo mund të jetë e detyruar të zgjedhë gjininë e fëmijës duke abortuar fetuset femër derisa të ngelet shtatzënë dhe fetusit të jetë djalë. Femrat pjesëmarrëse në studim dhanë shumë shembuj të zgjedhjes së gjinisë. Gjinekologët deklarojnë se numri i femrave që zgjedhin gjininë është në zbritje por e pranojnë që kjo praktikë ekziston dhe nuk është e rallë. Në të shumtën e rasteve femrat janë të detyruara të abortojnë nëse ka presion nga familja që të ketë djalë.

Në anën tjetër femrat edhe pse preferojnë të bëjnë djalë, tregojnë më shumë ndjeshmëri në këto raste. Meshkujt dhe femrat, në të shumtën e rasteve të rinjtë janë më tolerant sa i përket pranimit të djalit ose vajzës kohëve të fundit.



Megjithatë, në përgjithësi të pasurit djalë është shumë e rëndësishme.

*“Epo, kësaj radhe fitova vajzë. Herën tjetër shpresoj të kem fëmijë (duke menduar në djalë)”*

***Mashkull, bisedë joformale***

Sipas gjinekologëve, është e zakonshme që femra të abortoj fshehurazi duke pasur parasysh që burri i saj nuk do të lejoj edhe një vajzë të lind në familje gjë që mund t’ia rrezikoj martesën dhe familjen e gruas.

### **Aborti ‘Spontan’**

Edhe pse e ndaluar nga vjehrrit ose burri, disa femra pinë disa barëra në mënyrë që të ndërpresin shtatzëninë duke e quajtur abort ‘spontan’.

### **Shumë shtatzëni dhe shumë të shpeshta**

Shumë shtatzëni, shumë afër njëra tjetrës, mund të jenë të rrezikshme për nënën. Në këto raste, aborti duket të jetë opsioni kryesor. Shtatzënitë e shpeshta ose të pasurit mjaftë fëmijë ishin arsye të zakonshme për abortin e nxitur në mesin e femrave.

*“E ndërpreva shtatzëninë në marrëveshje me burrin; të dy u pajtuam që ishte shumë herret për edhe një fëmijë sepse djali im ishte vetëm 9 muajsh kur ngela shtatzënë për herë të dytë, kështu që herrën e tretë vendosa të abortoj sepse ne nuk donim të kishim më fëmijë. Kishim kushte të vështira të jetesës dhe askush në familje nuk punonte dhe thjeshtë nuk mund të paramendoja të kisha edhe fëmijën e tretë”.*

***Femër, 15-45, Mitrovica, urban, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)***

*“Epo, arsyeja kryesore ishte që djali im i tretë ishte akoma shumë i vogël, dhe para se ai të mbushte një vit unë do të duhej të lindja, kështu që pastaj do të kisha tre fëmijë shumë të vegjël për tu kujdesur. Do të duhej të ushqenim tre fëmijë përderisa vetëm burri im merrte rrogë...”*

***Femër, 15-45, Prishtinë, rural, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)***

*“Intervistuesi: Pse abortuat?”*

*Respondenti: Ne nuk donim të kishim më fëmijë, por prapë pas abortit ngela shtatzënë...”*

### *Femër, 15-45, Prizren, rural, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)*

Në përmbyllje, vendimi për ndërprerjen e shtatzënisë shpesh ndikohet prej shumë faktorëve. Shumë shpesh të ngelurit shtatzënë është e lidhur me kushtet e vështira ekonomike dhe përzgjedhja e gjinisë me problemet në familje dhe presioni i të pasurit djalë.

#### **Mosha e re e femrës**

Mosha e qifit, e veçanërisht e femrës është një arsye për të abortuar. Në këto raste aborti normalisht inicohet nga prindërit e vajzës që mendojnë se vajza e tyre është shumë e re dhe nuk duhet të sakrifikohet duke mbajtur fëmijën.

#### **'Ato për të cilat nuk flasim'**

Rrethanat në të cilat shfaqet shtatzënia e padëshiruar tek femrat e *pamartuara*, janë plotësisht ndryshe. Nëse mashkulli nuk pajtohet të martohet me femrën e cila ka ngelur shtatzënë, aborti duhet të bëhet fshehurazi dhe shumë shpejtë që askush të mos kuptojë për këtë. Kjo ndodhë për shkak të frikës nga thashethemet që përhapen shumë shpejtë (Shih po ashtu Kapitullin 3). Nëse njerëzit marrin vesh, mund të ketë shumë pasoja. Ajo femër gjithmonë do të mbahet në mend si 'kjo është ajo që ka abortuar' dhe gjasat që do të martohet do të jenë shumë të vogla. Sipas pjesëmarrësve në fokus grup, këto femra do të shikohen ndryshe të gjithë, përfshirë ndonjëherë edhe prindërit dhe familjen e tyre, do të distancohen nga ajo. Ajo do t'i turpërojë familjen dhe prindërit e saj do të hezitojnë t'i tregojnë tjerëve kush është vajza e tyre.

Duke pasur parasysh se nuk ka rrjetë të mbështetjes për nënat që rrisin fëmijë vetëm, rritja e fëmijës vetëm është shumë e vështirë, veçanërisht kur nuk mund të mbështeten në familjet e tyre për ndihmë. Shumica e femrave dhe meshkujve pjesëmarrës në studim pajtohen që nëse mashkulli refuzon të rrisë fëmijën e tij, aborti gjithsesi duhet të merret në konsiderim. Kjo ishte arsyeja më e shpeshtë pse femrat e pamartuara vendosin të abortojnë.

Mentaliteti lokal është se fëmijët që rriten vetëm nga njeri prind, edhe në kushte të mira të jetesës, janë gjithmonë të përjashtuar dhe diskriminuar nga më të vjetrit dhe moshatarët. Femrat deklarojnë se një ndër arsyet pse femrat e pa martuara duhet të abortojnë është ky lloj i diskriminimit. Sipas tyre, njerëzit tentojnë t'i etiketojnë dhe t'i thërrasin këta fëmijë me emra të ndryshëm, siç janë 'kopil'.



Kushtet ekonomike duket të jenë pengesë edhe për femrat e pa martuara. Kushtet e vështira të jetesës janë arsyeja e dytë më e shpeshtë pse femrat abortojnë.

## **NJOHURITË PËR METODAT E ABORTIT**

Metoda të ndryshme janë përdorur për ndërprerjen e shtatzënisë. Fillimisht këto metoda mund të ndahen në metoda kirurgjike për nxitjen e abortit (p.sh., me vakum), mjete kimike (barëra) dhe metoda tradicionale të abortit<sup>15,16</sup>.

Në përgjithësi, studimi nxjerr në pah se femrat nuk janë të vetëdijshme për metodat mjekësore të abortit, veçanërisht vajzat e reja që nuk kanë pasur abort. Megjithatë, kishte raste në të cilat edhe femrat të cilat kanë pasur abort nuk ishin të qarta dhe të sigurta se çfarë ka qenë metoda ose procedura mjekësore që është përdorur. Përgjigja më e shpeshtë në pyetjen lidhur me njohuritë për metodat mjekësore të abortit është që femrat i referoheshin si ‘pastrim’ ose ‘me instrumente metalike’ siç janë gërshërët ose pincat. Metoda me vakum është përdorur po ashtu si një ndër metodat e abortit.

Sipas gjinekologëve, metoda instrumentale e abortit është më e zakonshme. Edhe metoda të reja kanë filluar të përdoren siç janë metoda hermetike që është edhe metoda më e shtrenjtë. Klinikat private kanë filluar përdorimin e metodës thithëse për abort që është më pak e dhimbshme dhe më së lehti të bëhet. Metoda kirurgjike po ashtu përdoret në rastet kur aborti bëhet më vonë se në javën e 15 të shtatzënisë.

Pilulat si kontracepsion emergjent që janë efektive deri në 72 orë pas seksit të pambrojtur janë metodë tjetër e ndërprerjes së shtatzënisë. Megjithatë, gjinekologët deklarojnë se personeli mjekësor ka mungesë të informatave për këtë lloj kontrceptivi.

Çuditërisht, edhe meshkujt edhe femrat kryesisht flisnin për metodat tradicionale të abortit edhe pse ata deklarorin se këto metoda nuk përdoren më. Të kryerit nga shkallët, vrapimi, mbajtja peshave të rënda, të shqelmuarit e abdomenit ishin metoda të përmendura nga femrat dhe meshkujt. Pirja e birrës me maj të bukës dhe të ulurit në të nxehtë duket të jenë metoda shumë të shpejta për nxitjen e abortit. Metoda tjera të përmendura ishin edhe të ulurit në vaskë me ujë të nxehtë për disa orë, pirja e çajeve speciale, pirja e barërave kundër dhimbjeve me sasi më të mëdha ose e pilulave kontrceptive.



Metodë shumë e shpeshtë e përdorur në të kaluarën dhe sot po ashtu është shtrydhja dhe shtypja. Të administruara nga gratë e vjetra që janë të ‘specializuara’ në këtë teknikën e masazhës së stomakut ku fetusit vritet dhe pastaj ndahet nga nëna dhe hedhet jashtë. Megjithatë, disa mendojnë se ndonjëherë as këto teknika nuk funksionojnë.

*“Një fqinje e imja mundahej të barte gjëra të rënda vetëm që të abortoj, kështu që ajo mbante frigoriferin, divanin, por nuk bënin punë.”*  
**Femër, 15-45, Graçanicë, rural, Serbe e Kos. (Intervistë e thellë)**

*“...Është një truk me ‘andolët’, pasi që ato zgjerojnë enët e gjakut, femrat i marrin në mënyrë që të abortojnë. Ditën e parë e merr një, pastaj dy, pastaj tri dhe pastaj katër dhe kur të merr të pestën dhe pastaj menjëherë aborton”*  
**Femër, 15-25, Mitrovica, urban, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)**

*“Mundet, e kam provuar edhe vetë dhe shkova te mjeku dhe asgjë. E vendosë birrën në gotë të madhe dhe hedhë maj buke në të. E pinë dhe gjatë gjithë kohës qëndron para ngrohëses. Fqinja ime më ka treguar për këtë.”*  
**Femër, 26-45, Mitrovica, urban, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)**

## PASOJAT E PERCEPTUARA TË ABORTIT

Si në të gjitha procedurat kirurgjike, edhe metodat kirurgjike më të zakonshme kanë potencial për rrezik dhe komplikime serioze. Këto rreziqe përfshijnë: shpuarjen (perforimin) e mitrës, perforimin e zorrëve ose fshikëzës urinare, sterilitet dhe vdekje. Rreziku për komplikime rritet me zhvillimin e shtatzënisë por është rrezik më i vogël se që mund të ndodhë kur shtatzënia mbahet deri në fund<sup>17</sup>. Edhe pse akoma nuk është vërtetuar, aborti mund të ketë efekte anësore më afatgjate siç janë kanceri i gjirit. Në vazhdimësi, aborti mund të shkaktoj dhimbje embrionale dhe në disa raste mund të ndikoj shëndetin mendor<sup>18</sup>.

Shumica e femrave janë të vetëdijshme për pasojat e abortit të nxitur, veçanërisht nëse numri i aborteve arrin në më shumë se një. Megjithatë, kishte femra që mendonin se aborti në të vërtetë nuk ka ndonjë efekt anësor. Po ashtu kishte edhe femra që deklarorin se është mirë të kesh abort kohë pas kohe në mënyrë që të pastrohesh.



Gjakderdhja u radhit si një ndër pasojat më të shpeshta të abortit nga femrat që kishin abort.

Femrat përmendën pasoja të ndryshme duke filluar nga dhembja e shpinës, dhembja e syve, dhembje barku, dhembja e trupit gjatë ndërrimit të stinëve dhe gjakderdhja e tepërt deri në vdekje. Kanceri, problemet me zemër dhe sëmundje të tjera u përmendën por më rrallë.

Gjinekologët kryesisht iu referuan efekteve psikologjike të abortit. Aborti shumë shpesh përcillet me depresion. Femrat që kanë pasur abort raportuan të kenë qenë në depresion për një kohë, disa ndihen të traumatizuara duke dënuar veten dhe duke u penduar për atë që kanë bërë.

*“Ndjehesha keq emocionalisht dhe fizikisht. Ndjehesha e dobët; Nuk shihja mirë, trupi më dridhej gjatë gjithës kohës. Fëmijët ishin shumë të vegjël dhe kërkonin të ushqeheshin dhe të visheshin e unë nuk isha në gjendje të bëja asgjë. U ndjeva shumë keq tri ditë radhazi.”*

**Femër, 26-45, Mitrovica, urban, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

*“E kam të vështirë të flasë për gjinekologët (qetësi)...Pas abortit tim të fundit e kam edhe shumë vështirë të shkoj atje.”*

**Femër, 15-45, Mitrovica, urban, Serbe e Kos. (Intervistë e thellë)**

Në kulturën kosovare, më e keqja që mund t'i ndodhe një femre është steriliteti. Një ndër gjërat e para dhe më të rëndësishme që ndodhë pas martesës është që femra të ngelet shtatzënë. Pothuajse të gjitha femrat dhe meshkujt përmendën sterilitetin si një ndër pasojat kryesore të abortit, e në veçanti nëse ndodhë në shtatzëninë e parë. Disa interpretuan sterilitetin në bazë të religjionit – si ndëshkim nga Zoti – përderisa të tjerët e panë jo plleshmërinë si pasojë të abortit.

Gjinekologët nuk përmendën asnjë nga këto pasoja të abortit. Ata diskutuan nëse steriliteti mund të shkaktohet nga aborti. Sipas tyre, steriliteti mund të shkaktohen nga ndonjë infeksion që pason pas abortit e jo si komplikim i vetë procesit të abortit.

## **NDJENJAT PËR ABORTIN**

Studimi konfirmon hezitimin e qytetarëve shqiptarë të Kosovës për të shpre-

hur ndjenjat dhe emocionet. Gjithashtu edhe mekanizmat mbrojtës mund të vëzhgohen. Intervistuesi duhej të nxiste disa herë për të nxjerrë përgjigje nga femrat lidhur me ndjenjat e tyre për abortin.

Kryesisht gjatë intervistave të thella femrat rrallë kishin reagime emocionale. Ndoshta pse kishte kaluar një kohë qysh se kishin abortuar por ndoshta edhe ose thjeshtë ndjeheshin që nuk kanë bërë asgjë gabim, nuk ndjeheshin fajtor për veprimet e tyre. Në shumicën e rasteve arsyeja për abort është perceptuar të jetë shumë më e fortë sesa vepra dhe ndjenja e abortit.

*“Intervistuesi: Si u ndiet pas abortit fizikisht dhe emocionalisht?”*

*Respondenti: Ndihesha pak e lodhur dhe kisha të ftohtë por kur të kthehet forca, harron për të.”*

***Femër, 15-45, Prizren, urban, RAE e Kos. (Intervistë e thellë)***

Ndjenja të përziera janë shprehur nga femrat. Varësisht nga karakteri dhe mosha e femrave, ndjenjat janë shprehur ndryshe. Përderisa disa ishin shumë të kënaqura dhe të liruara, të tjerat përmendën që janë penduar për atë që kanë bërë. E disa do të donin të kthenin kohën prapa për të ndryshuar veprimet e tyre. Pjesëmarrëset në diskutim shprehen mendimi se femrat që kanë abortuar ndonjëherë, ato as që mendojnë ndonjëherë për të më. Megjithatë, kishte femra që tregonin pendimin e tyre për atë që kanë bërë. Femrat më të reja shprehen më pak pendimin e tyre sesa të vjetrat që ndjehesh më parë.

*“Pas dy aborteve të para, ndjehesha normal, ndonjëherë edhe e kënaqur sepse e kisha zgjidhur problemin. Kam vuajtur vetëm pas abortit të tretë. Ndonjëherë mendoja se çfarë moshe do të kishte ai fëmijë sot... Kurrë nuk mund t'ia falë vetes që nuk i dhashë jetë fëmijës tim të katërt.”*

***Femër, 15-45, Mitrovica, urban, Serbe e Kos. (Intervistë e thellë)***

## **KOHA PËR ABORT**

Shkencërisht, aborti në shtatzëni të hershme konsiderohet të jetë procedurë e thjeshtë. Kur bëhet nga mjeku profesionist, shtatzënia mund të ndërpritet më së voni në javën e 16<sup>të</sup>.<sup>19</sup>

Gjinekologët që morën pjesë në diskutim u shprehen se aborti duhet të bëhet brenda tre muajve të parë të ngjizjes. Pas saj, aborti mund të performohet vetëm me aprovimin e komisionit, varësisht nga arsyeja për abort.



Sipas Ligjit në fuqi<sup>20</sup> mbi Ndërprerjen e Shtatzënisë, “aborti duhet të performohet me kërkesën e gruas, brenda 10 javëve të para të shtatzënisë. Nuk kërkohet miratim i nënshkruar ose pritje; miratimi i prindit kërkohet për të miturit nën moshën 16 vjeçare.”

Megjithatë, disa dëshmi anekdotale tregojnë se disa klinika private bëjnë aborte edhe më vonë në shtatzëni. Femrat që morën pjesë në diskutime në grup tregojnë raste ku të afërmit dhe kushërinjtë e tyre kishin aborte edhe pas muajit të tretë të shtatzënisë. Thuhet se klinikat private bëjnë aborte edhe në muajin e pestë ose më vonë në shtatzëni, veçanërisht nëse mjeku është i afërt i pacientes ose nëse paguan shumë të lartë për abort.

*“Kam dëgjuar që një femër abortoi në muajin e pestë të shtatzënisë dhe kam dëgjuar se është shumë e rrezikshme për shëndetin e nënës nëse aborti bëhet pasi që të zhvillohet fëmija.”*

**Femër, 15-25, Prishtinë, urban, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

Femrat në përgjithësi janë të vetëdijshme për limitin kohor për abort prej familjarëve dhe miqve. Duke pasur parasysh faktin se njerëzit kanë tendencë të adaptojnë rregullat në mënyrën që atyre ju përshtatet më së miri, disa shpjegojnë kohën për abort si shumë të rëndësishme për shëndetin e nënës: “sa më shpejtë aq më mirë” për të reduktuar mundësinë e komplikimeve gjatë dhe pas abortit. Disa tjera thonë se aborti duhet të bëhet para se fëmija të ketë shpirt, pas saj është mëkat të abortohet. Shumica e femrave që kanë pasur abort e shpjegojnë kohën për abort në muaj dhe javë përderisa ato që e refuzojnë idenë për abort të gjitha i referohen mëkatit që bëhet nëse fëmija e fiton shpirtin dhe pastaj abortohet.

## **KU TË BËHET ABORTI (TË MARTUARA VS. TË PAMARTUARA)**

Rezultatet e studimit tregojnë që femrat preferojnë të shkojnë më parë në klinika private sesa në ato publike për shumë arsye. Këto arsye mvaren gjithashtu edhe nga çështja nëse femra që do të ketë abort është e martuar ose jo. Femrat e martuara në përgjithësi kërkojnë shërbim më të mirë, nivel më të lartë të higjienës, gjinekologët më të mirë dhe trajtim të mirë. Shumica e femrave pjesëmarrëse në studim deklarojnë se klinikat publike nuk mund të ofrojnë këso shërbimesh dhe kjo është arsyeja pse shumica e tyre më parë do të shkonin në klinika private të bëjnë abortin. Në fund të fundit, atë ndjejnë se sjellja e mjekut ndryshon dhe është më e mirë kur

## **Korniza 1.**

*Intervistuesi: Ju thatë që keni pasur katër aborte, a po?*

*Respondenti: Po, katër aborte i kam pasur.*

*Intervistuesi: Dhe abortet i keni pasur pas lindjes së shtatë fëmijëve?*

*Respondenti: Po, të gjitha radhazi i kam pasur. Nuk është mirë ajo që kam bërë; e di që nuk ka nënë që i pëlqen të ketë abort por s'ke çfarë bën kur nuk ke kushte të mira për jetesë.*

*Intervistuesi: Kur morët vesh për shtatzënitë e padëshiruara çfarë bëtë? Si vendosët t'i ndërprisni këto shtatzëni? Me kë biseduat?*

*Respondenti: V'jehrra ime që vdiq dy vite më parë, thoshte që unë nuk e doja djalin e saj sepse nuk doja të kisha më fëmijë me të. U përpoqa ta bindja të kundërtën sepse unë dbe burri im kishim marrëveshje.*

*Intervistuesi: Ku i bëtë abortet?*

*Respondenti: Në spital, por mu deshtë të paguaja për gjithçka*

*Intervistuesi: Kush ju rekomandoi të shkoni atje?*

*Respondenti: Askush, shkova vetë.*

*Intervistuesi: Sa paguat?*

*Respondenti: Nuk e di sa ishte në atë kohë por për dy të fundi pagova një herë 25 dhe herën tjetër 50.*

*Intervistuesi: Çfarë metode përdori mjeku për abort?*

*Respondenti: Nuk ndjeva asgjë sepse më dhanë injeksion dhe nuk kam ditur asgjë derisa nuk jam zgjuar dhe gradualisht kam filluar të kthjellem.*

*Intervistuesi: A keni dëgjuar për metoda tjera të abortit?*

*Respondenti: Mund t'ju them për të parën që e kam pasur pas luftë. Më dërguan në dhomë dhe nxorën të gjitha motrat medicinale jashtë. Pastaj më pyetën për emër dhe fillova të frikobem pak sepse pasbë ato instrumentet metalike dhe disa prej tyre i përdorën në mua, pastaj fillova të ndiej mpirje dhe më pas nuk ndjeva më asgjë. Kur u zgjova gjithçka ishte njëjtë por pastaj pas një jave filluan dhimbjet.*

*Intervistuesi: A ju këshilloj mjeku se si të mbroheni më pas? Ose, a ju tha që të shkoni në kontrollë?*

*Respondenti: Po. Më thanë që dubet të mbrohem. Dhe sapo kam filluar përdorimin e atyre pilulave nuk kam pasur më problem.*

*Intervistuesi: Si u ndiet pas abortit?*

*Respondenti: S'kishte më çfarë të bëhej; e kisha ndjenjën që problemi u zgjodh.*

**Femër, 15-45, Prishtinë, rural, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)**

paguan. Mbi të gjitha, sipas pjesëmarrësve në studim, në klinikat private nuk është e nevojshme të pritet gjatë për abort si në klinikat publike. Megjithatë, disa femra që kanë pasur abort më herët dhe e kanë bërë atë në spital, janë të kënaqura me kushtet dhe trajtimin.

Për femrat e pamartuara, prioritetet ndryshojnë. Konfidencialiteti është prioritet kur femra e pamartuar kërkon abort. Sipas gjinekologëve që morën pjesë në studim, konfidencialiteti nuk mund të sigurohet në klinikat publike. Informatat personale të pacientit janë të nevojshme dhe mbi të gjitha, pacientët e shohin njëri tjetrin. Gjasat që pacientët të njihen me njëri tjetrin janë shumë të mëdha sepse të gjitha qytetet e Kosovës janë relativisht të vogla. Si rezultat, femrat e pamartuara preferojnë të kenë abort në klinika private ose edhe më e preferueshme është ta bëjnë atë në qytet tjetër ose jashtë Kosovës. Përderisa shqiptaret kosovare kryesisht shkojnë në qytet tjetër, serbet e Kosovës dalin jashtë Kosovës, kryesisht në Serbi.

*“Nënat e pamartuara shkojnë në qytete tjera për të abortuar për shkak të konfidencialitetit! P.sh., nëse nëna jeton në Pejë, ajo shkon në Prizren ose Gjakovë të abortoj dhe e kundërta”.*

***Gjinekolog, Prishtinë, urban, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)***

*“Për shkak të kritikave dhe thashethemeve, nënat e vetme i ikin aborteve në institucione publike! Vetëm disa i bëjnë aty!”*

***Gjinekolog, Prishtinë, urban, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)***

*“Vajzat e pamartuara shkojnë në Beograd për abort. Kështu që askush të mos e kuptoj se çfarë ka bërë.”*

***Femër, 15-25, Çagllavicë, rural, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)***

*“Ato shkojnë në Krushevc. Varet. Është e rëndësishme të fshihet që askush të mos kuptoj për të.”*

***Femër, 15-25, Çagllavicë, rural, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)***







## KAPITULLI 3 NJOHURITË PËR MJETET KONTRACEPTIVE DHE PËRDORIMI I TYRE

Studimi i literaturës për këtë hulumtim tregon se nuk ekziston korrelacion pozitiv në mes të njohurive për mjetet kontraceptive dhe përdorimit të tyre. Sipas Studimit demografik, social dhe të shëndetit riprodhues (2003), 97 përqind e femrave kanë dëgjuar për së paku një metodë kontraceptive. Femrat më së shumti kishin njohuri për tabletat dhe për spiralet – DIU (90 përqind). Një studim tjetër në mesin e të rinjve (Care International – Raport hulumtues mbi “Njohuritë, qëndrimet, besimet dhe praktikat seksuale dhe riprodhuese” për të rinjtë meshkuj dhe femra, 2005) tregon se rreth 75 përqind e të rinjve kanë dëgjuar për prezervativët dhe vetëm 27 përqind në fakt përdorin metoda kontraceptive (81 përqind prej tyre përdorin prezervativë).

Rezultatet nga diskutimet në grup tregojnë një vetëdije të lartë për metodat kontraceptive, së paku për DIU dhe për tabletat. Kjo njohuri bazohet në atë se çka kanë dëgjuar pjesëmarrësit nga të tjerët, e jo në informatat që i kanë marrë ata drejtpërsëdrejti, nga personeli shëndetësor ose profesionistë të tjerë.

Megjithatë, femrat e zbulojnë mungesën e informatave në lidhje me përdorimin aktual të mjeteve kontraceptive. Në mesin e dispozitivëve intrauterin që janë në dispozicion në tregun e Kosovës janë Intragal-i, Diargentum-i dhe Biocuprum-i. Një nga kërkesat më të rëndësishme për përdorimin e DIU-së



është të kryhen vizita të rregullta gjinekologjike<sup>21</sup>. Por, praktikat e femrave për të vizituar mjekun, e sidomos gjinekologun, janë mjaft të rralla. Siç thuhet në një studim hulumtues<sup>22</sup> të zhvilluar nga Instituti i Kosovës për Shëndetësi Publike, Departamenti i Epidemiologjisë, një numër shumë i vogël i popullatës së Kosovës kanë shprehinë e kontrollimeve shëndetësore rutinore. Ata zakonisht kërkojnë kujdes profesional kur paraqiten probleme të veçanta, ose kur dëgjojnë nga miqtë për karakteristikat dhe simptomat e sëmundjeve.

Metodat kontraceptive të ofruara nga qendrat e shëndetit publik megjithatë nuk janë përmendur aq shpesh. Pasi që femrat i kryejnë abortet kryesisht në klinika private, metodat kontraceptive nuk u ofrohen falas. Megjithatë, atyre femrave që kanë kryer aborte në klinika publike u janë ofruar mjete kontraceptive falas e disave u është ofruar edhe DIU. Sa u përket atyre që kurrë nuk kanë pasur abort, këto femra nuk kishin njohuri për mjete kontraceptive falas pas abortit. Rezultatet e studimit tregojnë se mjetet kontraceptive ofrohen falas nga klinikat publike vetëm femrave që kanë pasur abort, që domethënë se mjetet kontraceptive u ofrohen falas pacienteve pas abortit e jo për të parandaluar shtatzënitë.

Pjesëmarrëset përmendën efektet anësore të “metodave kontraceptive” dhe thanë se efektet anësore i bëjnë ato që mos t’i përdorin këto mjete. Përgjigjet përfunduese në lidhje me këtë gati në secilin fokus grup ishte se “Mënyra më e mirë është mënyra natyrore.”

Hipoteza fillestare në lidhje me përdorimin e mjeteve kontraceptive ishte se femrat në regjionet urbane janë më shumë të vetëdijshme për mjetet kontraceptive dhe se i përdorin më shumë ato. Si duket nuk është kështu, siç u vërtetua nga fokus grupet. Femrat më të vjetra, pa marrë parasysh a jetojnë në regjionet urbane apo rurale, kishin përgjigje të njëjta. Grupi i femrave më të moshuara në komunitetet e serbeve të Kosovës mendon se përdorimi i mjeteve kontraceptive nuk është mënyra më e mirë për parandalimin e shtatzënisë së padëshiruar. Femrat më të moshuara preferonin metodën e ashtuquajtur “tërheqje” ose metodën “ritmike”.

Megjithatë, femrat serbe të Kosovës përmendën rrezikun e metodës së tërheqjes dhe deklaruan se nëse metoda e tërheqjes është metoda e vetme që përdoret në një lidhje, duhet të ekzistojë besimin në mes të partnerëve. Përderisa femrat serbe të Kosovës kryesisht ua lënë fajin burrave të tyre për shkaktimin e shtatzënisë së padëshiruar, femrat shqiptare të Kosovës kryesisht e fajësojnë veten.

*“Në ndërprerjen e marrëdhënies seksuale (kur përdoret metoda e tërheqjes) duhet të kesh shumë besim në partnerin tënd. Kjo duhet të jetë një lidhje e fortë dhe serioze, që t’i besosh mashkullit se do të ndalet kur është më së ëmbli për të, ashtu që të mbrojë ty.”*

**Femër, 15-25, Çagllavicë, rural, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)**

Femrat e reja kishin mendimet të ndryshme. Prezervativët ishin mjete kryesor për mbrojtje. Shumica e femrave të reja përmendën prezervativët si metodë kontraceptive. Në disa raste, tabletat gjithashtu përdoshin nga femrat e reja.

Femrat e reja ishin ambivalente në lidhje me përdorimin e mjeteve kontraceptive. Opinionet e tyre nuk ishin bardh e zi. Ato u munduan të tregojnë edhe për përparësitë edhe për të metat e mjeteve kontraceptive. Sipas tyre, prezervativët janë më të përshtatshëm në krahasim me metodat tjera kontraceptive, efektet anësore nuk janë me pasoja dhe janë më praktikë.

Sa u përket meshkujve, preferencat dhe opinionet e tyre për përdorimin e mjeteve dhe metodave kontraceptive janë krejtësisht të ndryshme. Me siguri për shkak të dallimeve në moshë dhe vendbanim, rezultatet tregojnë dy ekstreme të kundërta. Përderisa meshkujt më të vjetër që jetojnë në regjionet rurale ishin më pak të kujdesshëm dhe më pak të ndjeshëm duke menduar vetëm për nevojat e tyre personale, grupet e meshkujve më të rinj në regjionet urbane ishin më të ndjeshëm në këtë aspekt. Njohuritë për mjetet kontraceptive ishin më të mëdha në mesin e meshkujve më të rinj.

Femrat e reja në përgjithësi ishin më pak të vetëdijshme për metodat kontraceptive, përveç të rejave serbe të Kosovës dhe femrave nga qyteti i Prishtinës. Duke qenë edhe pa përvojë ato nuk ishin të vetëdijshme për metodat kontraceptive në përgjithësi.

Sipas pjesëmarrësve, edukimi për mjetet kontraceptive është shumë i kufizuar. Burimi kryesor i informatave është nga miqtë, sidomos në mesin e të rinjve. Femrat më të vjetra kryesisht mësojnë për mjetet kontraceptive në qendra shëndetësore, edhe në ato private edhe në ato publike, si dhe prej mjekëve që sugjerojnë lloje të ndryshme të mjeteve kontraceptive. Broshurat, pllakatet dhe informatat në televizion për mjetet kontraceptive janë mjaft të rralla. Gati të gjithë pjesëmarrësit kishin të njëjtin mendim se duhej të kishte më shumë informata në dispozicion, sidomos në TV ku mund të arrihet shumica e popullsisë, si dhe në shkolla ku fëmijët mund të edukohen në mënyrë



të veçantë për metodat kontraceptive dhe përdorimin e tyre në veçanti.

## **ABORTI, PASTAJ MJETET KONTRACEPTIVE?**

Femrat që kanë pasur abort pritet të jenë më të kujdesshme në të ardhmen dhe të mësojnë nga gabimet e tyre. Mirëpo, ky nuk është realiteti. Edhe pse disa femra pendohen për abortimin e fëmijës apo fëmijëve të tyre, duket se pendimi është vetëm i përkohshëm. Ndjenjat e fajit zhduken shpejt në shumicën e rasteve.

Shumica e femrave të intervistuar thanë se edhe pse janë betuar se menjëherë do të fillonin të përdornin mjete kontraceptive, vetëm disa prej tyre në të vërtetë e kanë bërë këtë. Disa ndaluan së përdoruri ato për një kohë, derisa të tjerat vazhduan me “shprehjet e tyre të vjetra” për arsye të ndryshme.

Disa femra që kanë pasur abort thanë se arsyeja pse kanë vazhduar me metodën e “tërheqjes” është thjesht sepse nuk dëshirojnë të përdorin mjete artificiale për kontracëpsion. Ato nuk i pëlqejnë as tabletat, as DIU-të apo çka do tjetër artificiale.

Të tjerat thjesht nuk kanë mundur të gjejnë një metodë adekuate kontraceptive për shkak të efekteve anësore ose për shkak të mungesës së kënaqësisë që disa metoda i shkaktojnë. Disa nga femrat e kanë lënë pas dore këtë çështje për ca kohë, duke thënë se nuk kanë pasur kohë.

Në mesin e këtyre femrave ka pasur edhe të tilla që menjëherë e kanë vënë DIU-në ose që kanë vendosur të përdorin metoda të tjera kontraceptive për parandalim.

### **Korniza 2. Rasti i një femre që ka pasur abort**

*“Pas abortit e bleva një DIU. I pagova 500 dinarë (rreth 6 Euro). Por nuk e vendosa. Planifikojta të shkoja te i njëjti mjek dhe ta vendosja DIU-në, por ndoshta DIU-së i ka kaluar afati tashmë. Duhet ta shikoj këtë.”*

*Dikush më thotë përdore, dikush thotë mos – nuk jam e sigurt se a është shëndetshme apo jo. Kurrë në jetë nuk kam përdorur mbrojtje. Kam dëgjuar për prezervativë dhe për tableta por asnjëherë nuk i kam provuar. Fëmijët në rrugë flasin për to. Njëherë burri im bleu prezervativë dhe e pyeta, çka janë ato? “Të lutem hidbi ato, gjuaji”, i thasbë. Nuk munda t’i provoja. Kjo ishte 7 apo 8 vjet më parë dhe nuk i provova. As nuk e di se si duken – disa thonë se janë të mira për mbrojtje. Asnjë nga shoqet e mia nuk përdor tableta; as për ato nuk e di se si duken. Kurrë nuk do t’i provoja. Kam dëgjuar edhe për DIU, por vetëm po më rri në shtëpi.”*

*Femër, 15-45, Graçanicë, rural, Serbe e Kos. (Intervista e thellë)*

## DISPOZITIVI INTRAUTERIN - SPIRALJA (DIU)

Spiralja është metoda më e përfolur kontraceptive nga pjesëmarrësit, veçanërisht nga femrat më të vjetra. Edhe pse shumica e femrave që kanë marrë pjesë në fokus grupe nuk e kanë përdorur personalisht, ato kishin mësuar për DIU-në kryesisht nga shoqet, fqinjët ose të afërmit. DIU gjithashtu perceptohet nga pjesëmarrësit si metoda më e sigurt kontraceptive, edhe pse jo më e lehta për t'u përdorur. Ideja e vendosjes së një objekti artificial brenda trupit të tyre ishte e frikshme.

DIU është gjithashtu mjete kontraceptive që rekomandohet më së shumti nga gjinekologët. Sipas tyre, femrat që nuk dëshirojnë të bëjnë më fëmijë duhet të përdorin DIU-në.

Sipas Federatës për Planifikim Prindëror në Amerikë (PPFA)<sup>23</sup>, DIU ka shumë përparësi, nuk ndikon në nivelin e hormoneve të femrës, është shumë i përshtatshëm në marrëdhëniet spontane seksuale, përmirëson jetën seksuale të femrës dhe është e mundur që femra të mbetet shtatzënë shpejt pas heqjes së DIU-së. Përveç se është metoda më e popullarizuar e parandalimit dhe se konsiderohet si më e sigurt, as gjinekologët e as femrat nuk i përmendën këto përparësi të DIU-së. Femrat kryesisht u përqendruan në mangësitë e DIU-së.

Pjesëmarrësit thanë se DIU nuk i përshtatet çdokujt. Varësisht prej trupit të femrës, disa femrave u përshtatet DIU shumë mirë, përderisa disave u është dashur ta heqin për shkak të efekteve anësore që ka shkaktuar DIU.

Sipas Federatës për Planifikim Prindëror në Amerikë (PPFA)<sup>24</sup>, femra duhet ta vizitojë mjekun për të kuptuar se a mund të përdor DIU-në dhe mjeku do të duhej t'i bëjë disa teste në lidhje me këtë. Domethënë, nuk mund të përdor çdokush DIU. Asnjë nga pjesëmarrëset në fokus grupe apo femrat e intervistuar që kanë përdorur DIU nuk kanë përmendur se janë kontrolluar në ndonjë mënyrë para vendosjes së DIU-së.

Femrat kanë përmendur efektet e ndryshme anësore të DIU-së, që kanë qenë kryesisht të ndërlidhura me çështje shëndetësore. Disa kanë zbuluar se pas vendosjes së DIU-së, ato kanë vuajtur nga anemia, sëmundje të mëlçisë dhe kanë pasur më shumë gjakderdhje sesa zakonisht. Femrat gjithashtu kanë përmendur se kanë qenë të kufizuara për bartjen e gjërave dhe në aktivitete të tjera të ngjashme kur kanë qenë duke përdorur DIU.



Pjesëmarrëset treguan edhe efekte të tjera anësore të DIU-së. Disa femra treguan për raste kur femrat kanë mbetur shtatzënë gjatë kohës kur kanë qenë duke mbajtur DIU. Disa femra gjithashtu shprehën përvojën e tyre personale në lidhje me DIU.

*“Po, por nuk e kam ditur se kishte lëvizur. Kisha bartur ca lule dhe gjëra të rënda dhe vëreja se nuk ndihesha mirë, kisha pak gjak por jo si gjakderdhje, por si copa të vogla. Shkova te mjeku dhe më tha se kam mbetur shtatzënë mbi DIU, e hoqa dhe u pastrova.”*

**Femër, 26-45, Prishtinë, rural, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

*“E vendosa DIU tre vjet pasi e linda vajzën time të tretë. Në muajin e parë pas vendosjes ndjeva dhimbje. Dhembja është e njëjtë sikur dhembja gjatë ciklit menstrual. Çdo ditë ndjen dhembje shpine dhe dhembje barku. Por pas një muaji nuk ndjen fare më dhimbje. Mësohesh krejtësisht me DIU-në. Është e rëndësishme që gjatë bartjes së DIU-së të kontrollohesh çdo gjashtë muaj. Pas tre vjetëve e hoqa DIU-në dhe vazhdova kontrollin e lindjes në mënyrë natyrale po mjete kontrceptive.”*

**Femër, 26-45, Çagllavicë, rural, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)**

*“Kam pasur DIU, por ndodhi gjëja më e keqe. Filloi të rritet në mitrën time dhe u desh ta heqin duke më operuar”*

**Femër, 26-45, Mitrovicë, urban, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)**

## TABLETAT “KUNDËR SHTATZËNISË”

Pjesëmarrësit në studim përmendën shpesh edhe pilulat edhe pse në përgjithësi pilulat nuk përdoren shpesh. Këtyre pilulave kryesisht iu referohen si pilula ‘kundër shtatzënisë’ (*hapa kundër shtatzënisë*). Ka asocim me barërat që dikush i merr kur sëmuret. Gjithashtu pjesëmarrësit përmendën jonnatyrallitetin e të vendosurit kemikale në organizëm çdo ditë. Mangësi e pilulave është se duhet të merren çdo ditë pa përjashtime.

Mbi të gjitha, sipas femrave, të shtuarit në peshë është efekti anësor më i keq dhe më i shpeshtë i pilulave ‘kundër shtatzënisë’. Të gjitha femrat përmendën të shtuarit peshë si problemi më brengosës i kontraktivëve pilula. Nervoza, anksoziteti, ndikimi negativ psikologjik janë po ashtu efekte anësore të perceptuara. Po ashtu çrregullimet hormonale janë përmendur në disa raste që çojnë deri te rritja e stomakut dhe gjoksit si dhe shkaktojnë rritjen e mjekrës

dhe mustaqeve. Disa prej femrave po ashtu përmendën se nuk mund të ngelësh shtatzënë menjëherë pas ndërprerjes së përdorimit të këtyre barërave – është vështirë. Megjithatë, kishte edhe femra që përshkruanin plotësisht të kundërtën: sipas tyre, çështja e të ngelurit shtatzënë është më shumë për shkak të organizmit të femrës sesa efektit të barërave.

Meshkujt nga Prishtina përshkruajnë pilulat ‘kundër shtatzënisë’ si thikë me dy teha. Në një anë të mbrojnë shumë mirë përderisa në anën tjetër kanë shumë efekte anësore.

Edhe pse e pa vërtetuar shkencërisht, disa femra thonë se pilulat kanë ndikim negativ në sistem nervor, mund të shkaktojnë kancer, shkatërrojnë fetusin e ardhshëm, mund të krijojnë cista dhe nëse përdoren një kohë të gjatë, mund të shkaktojnë sterilitet.

*“Sa më përket mua, është më lehtë të abortosh sesa të marrësh barëra. Kam dëgjuar shumë gjëra që ju ndodhin femrave që marrin pilula. Aborti është më natyral sesa ato barëra që i fut në organizëm. Me pilula ia rrezikon vetës shëndetin”.*

**Femër, 15-25, Mitrovicë, urban, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)**

Pilulat ‘kundër shtatzënisë’ përdoren edhe për qëllime tjera. Ato përshkruhen nga mjekët për rregullimin e ciklin menstrual dhe të hormoneve. Disa femrave iu duken shumë efektive përderisa të tjerat i ndërpresin menjëherë. Pilulat për mbrojtje nga shtatzënia përdoren edhe për iniciimin e abortit (shih Kapitullin 4). Disa femra deklarojnë se kur dyshonin se janë shtatzënë, ato merrnin pilula kundër shtatzënisë në mënyrë që të stimulojnë menstruacionet.

## **PËRDORIMI I KONDOMËVE**

Pas konfliktit në Kosovë në vitin 1999, kishte seri të kampanjave të vetëdijësimit dhe reklama të kondomëve. Një Dhjetori është Dita Botërore Kundër Sidës ku vëmendje e veçantë i kushtohet përdorimit të kondomëve që përdoren si mjet kundër sidës. Reklamat kishin ndikim mirëpo tema e kondomëve si mbrojtës ndaj shtatzënisë nuk është promovuar. Gjithashtu, siç nxjerrin diskutimet në grup, programet për vetëdijësim të përdorimit të kondomëve janë më të fokusuar për të rinjtë. Pjesëmarrësit më të rinj në studim kryesisht përmendnin kondomët si mjete për kontrollimin e shtatzënisë si dhe mbrojtjen nga sëmundjet e ndryshme. Mbrojtësi më i përshtatshëm për rininë del të jetë kondomi.

Disa femra të martuara, pas provimit të mënyrave të ndryshme për mbrojtje



nga shtatzënia e padëshiruar, tregojnë se kondomët duket t'ju përshtaten më së shumti. Përparësia e kondomëve krahasuar me lloje tjera kontraceptive është që nuk është e nevojshme të merren barëra (pilula për mbrojtje ndaj shtatzënisë) dhe nuk është e nevojshme të vendoset spiralja nga mjeku dhe të mos ndihesh rehat me objekt të huaj brenda organizmit.

Reagimi i parë kur janë pyetur femrat e reja për kondomët ka qenë “zgjidhje e mirë, na ka shpëtuar.”

Meshkujt më të rinj i preferojnë kondomët sepse kanë më pak efekte anësore përderisa metodat tjera siç janë pilulat dhe spiralja kanë efekte anësore negative për femrat. Në anën tjetër, meshkujt më të vjetër që jetonin në zonat rurale – edhe pse të vetëdijshëm për efektet anësore të spirales dhe pilulave, ata preferonin këto dy lloje. Marrëdhënien seksuale me kondom ata e përshkruanin si:

*“Kondomët ngjajnë trangullit të konservuar i cili nuk është aq i shijshëm sikurse ai i freskët. Por nëse janë të lirë, njerëzit i përdorin.”*  
**Mashkull, 26-45, Prizren, rural, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)**

*“Pajtohem! Të përdorurit kondomë është sikur të lahesh me rroba.”*  
**Mashkull, 26-45, Prizren, rural, Shqip. i Kos. (Diskutim në grup)**

Meshkujt e ri në Prishtinë ishin shumë mirë të informuar për përdorimin e kontraktivëve dhe efektet anësore të tyre. Krahasuar me vajzat e moshës së njëjtë, ata dinin shumë më shumë për gjithçka. Në fakt, ata ishin të vetmit që përmendën pilulat kontraceptive pas marrëdhënies seksuale që mund të përdoren deri në 72 orë pas marrëdhënies seksuale (Kontrceptivi emergjent).

Disa nga mangësitë që femrat përmendën ishin: kondomët mund të shqyhen gjatë marrëdhënies seksuale dhe shumë femra u ankuan për mungesën e kënaqësisë gjatë përdorimit të kondomëve. Për disa femra kondomët mund të jenë frustruese madje edhe mund të shkatërrojnë lidhjen për shkak të mungesës së kënaqësisë.



### **Korniza 3.**

*Kam provuar përdorimin e kondomëve. S'ka kënaqësi. E kam parë edhe burrin të pakënaqur me përdorimin e kondomëve. Kam menduar për kondomët dhe konkludimi im është që edhe pse të mbrojnë nga shtatzënia e padëshiruar ose nga sëmundjet e ndryshme, ato shkatërrojnë marrëdhënien mes partnerëve. Ku është romanca kur mashkulli e merr kondomin nga xhepi dhe e vendosë? Kjo do të më shkatërronte në tërësi. Çfarë tjetër, spiralja? Kurrë nuk do ta vendosja. E kam ndjenjën se do ta ndieja në trupin tim gjatë gjithë kohës. Kështu që metoda e tërbeqjes mbetet kontraktivi i vetëm për mua.*

*Femër, 15-45, Mitrovicë, urban, Serbe e Kos. (Intervistë e thellë).*

### **“NDALU KUR ËSHTË MË SË MIRI”: METODA E NXJERRJES**

Metoda e nxjerrjes (coitus interruptus) si metodë kontraktive duket të jetë metoda më e shpeshtë dhe më e përdorur në mesin e pjesëmarrësve. Metoda e nxjerrjes shprehet kështu:

“burri kujdeset për mua”,  
“metoda natyrale”,  
“metoda tradicionale”,  
“asgjë”,  
“mbrojtje e vetëdijshme”,  
“ndalu kur është më së miri”

Shumica e femrave pjesëmarrëse në fokus grup dhe ato që morën pjesë në intervista të thella deklarojnë që përdorin këtë metodë. Ato janë të vetëdijshme që kjo nuk është metoda më e sigurt, megjithatë, është metodë që ju përshtatet më së shumti. Pasi që disa femra nuk preferojnë të marrin pilula kundër shtatzënisë. Të vendosin spiralë ose të përdorin kondomë, nxjerrja mbetet opsioni më i mirë. Shumica e femrave kanë kaluar në këtë metodë pasi që provuan lloje të ndryshme të metodave kontraktive përderisa disa femra tjera deklarojnë se nuk kanë përdorur metoda tjera fare.

Vendimi për mospërdorimin e metodave kontraktive sipas femrave është kryesisht vendim që merret nga mashkulli ose në raste të rralla vendim i përbashkët. Kryesisht vendimi i lihet mashkullit. Sipas femrave, matura seksuale është më se e nevojshme kur përdoret metoda e nxjerrjes. Së pari duhet ti besosh burrit dhe ai duhet të jetë mjaftë i ndjeshëm që të kuptoj pozitën e gruas. Në disa raste, femrat i besojnë burrave të tyre edhe më shumë se spirale, pilulave dhe kondomëve.



*“Epo, e gjitha kjo varet nga partneri, sa është i kujdesshëm. Disa meshkuj nuk brengosen. Unë kisha marrëveshje me burrin tim dhe ai e di sa kam vuajtur, kështu që më pastaj ai u bë shumë i kujdesshëm.”*  
**Femër, 15-45, Prishtinë, urban, Shqip. e Kos. (Intervistë e thellë)**

Fatkeqësisht, në shumicën e rasteve kjo është më e mira që mund të ndodhë. Në vendimmarrjen për përdorimin e kontraktivëve e gjitha mvaret vetëm nga mashkulli, çfarëdo që t'i pëlqej atij. Përderisa në fund ai rrallë e merr përgjegjësinë, veçanërisht kur meshkujt janë nën ndikimin e alkoolit ose të “pavetëdijshëm”.

*“E di një martesë. Ata kanë katër fëmijë dhe ajo ka pasur 15 aborte. Ajo mbetet shtatzënë sepse ai ishte i pirë. Ky është shembull i qartë i dhunës seksuale në martesë”.*

**Femër, 26-45, Mitrovica, urban, Serbe e Kos. (Diskutim në grup)**

*Shkruan edhe në libër. Është mbrojtje e vetëdijshme! Femrat nuk mund ta bëjnë por meshkujt duhet të jenë të kujdesshëm dhe të mos e lënë femrën shtatzënë! Nëse është i kujdesshëm ai mund ta kursej gruan! Nëse mashkulli nuk është i pirë ai mund të jetë i kujdesshëm gjatë marrëdhënies seksuale! Nuk jam e vetmja që e përdorë këtë metodë! Ka shumë femra që e përdorin këtë metodë natyrale për tu mbrojtur!*

**Femër, 26-45, Mitrovica, rural, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

*“Pa dëshirën e burrit për kujdes, gruaja nuk mund të bëj gjë”.*

**Femër, 26-45, Prizren, rural, Shqip. e Kos. (Diskutim në grup)**

Gjinekologët deklarojnë se edhe pse nxjerrja është metoda më e popullarizuar, po ashtu është edhe metoda më e rrezikshme. Metoda e nxjerrjes ofron vetëm 30 përqind siguri sipas tyre.

E vetmja pasojë e metodës së nxjerrjes është shtatzënia. Edhe pse disa femra veç kishin ngelur shtatzënë me përdorimin e kësaj metode, ato vazhdonin ta përdornin.

Metoda e nxjerrjes është përgjithësisht metoda kontraktive më e preferuar, jo për shkak se është falas por sepse lejon kënaqësi maksimale pa efekte anësore të kontraktivëve modern.





## KAPITULLI 4 PËRMBLEDHJE, KONKLUZIONE, DISKUTIM DHE REKOMANDIME

Ky studim fokusohet në perceptimet dhe mendimet e meshkujve dhe femrave mbi ndryshimet për abortin dhe përdorimin e kontraktivëve në shoqërinë kosovare. Perceptimet dhe mendimet janë të lidhura me trendet sociale siç janë kushtet e përgjithshme ekonomike të vështira por edhe modernizimi, ndikimi i diasporës në mbështetjen financiare të familjeve në Kosovë, ndryshimet në mendimet për seksin para martesor dhe sjelljeve tjera seksuale, ndryshimi i vlerave të shtatzënisë dhe kujdesit para lindjes të ofruar në shërbimet shëndetësore dhe mbi të gjitha ndryshimet e pozitës së gruas në shoqëri.

Në mënyrë që të gërmojmë më thellë për arsyet e abortit dhe mendimet dhe perceptimet për abortin si një kontrollë e lindjes, hulumtimi përfshinë studimin kualitativ me diskutime në grup dhe me intervista të thella. Në fokus grupe femrat shpreheshin lirshëm lidhur me përvojën e fqinjëve, motrave, shoqeve por jo edhe me përvojën e tyre personale. Diskutimi i përvojës së tyre me abortin gjatë intervistave të thella ishte shumë më delikat dhe i ndjeshëm por femrat na treguan historinë e tyre, në intervistat që zgjasnin rreth 30 minuta.

Administrimi i fokus grupeve dhe intervistave të thella është më shumë veprim, intervenim, sesa vetëm hulumtim. Me diskutimin për abortin, seksu-



alitetin, përdorimin e kontraceptivëve në kontekstin social të Kosovës, kanë dalur në sipërfaqe çështjet, duke krijuar vetëdijësim dhe diskutim në mesin e pjesëmarrësve.

Rezultatet e fokus grupeve dhe intervistave të thella janë transkriptuar dhe përkthyer tërësisht në gjuhën angleze. Transkriptet janë analizuar bazuar në rregullat e teorisë 'Bazale'. Për këtë është përdorur paketi i softuerit Atlas-TI.

Ky studim, për shkak të natyrës së vet kualitative, vetëm përshkruan mendimet dhe perceptimet e grupeve të ndryshme të intervistuar. Këto grupe janë zgjedhur në mënyrë reprezentative për shoqërinë kosovare. Megjithatë, rezultatet e fokus grupeve dhe intervistave të thella kurrë nuk mund të kuantifikohen. Kuantifikimi i mendimeve dhe perceptimeve mund të bëhet vetëm në hulumtim reprezentativ për popullatën e Kosovës (nivel kombëtar).

Duke marrë parasysh rezultatet e fokus grupeve dhe intervistave të thella duke llogaritur në rezultatet e fokus grupeve dhe intervistave të thella ky hulumtim nxjerr në shesh informata të rendësishme për shoqërinë kosovare

## **Abortet**

Aborti është i përhapur në Kosovë me dallim të qartë në mes të femrave të martuara dhe atyre të pamartuara. Femrat treguan perceptime, arsye dhe pasojat të ndryshme për abortin.

Aborti është i pranueshëm në përgjithësi nëse bëhet për arsye shëndetësore, abnormalitet të fetusit dhe dhunës seksuale. Gjithashtu, mendimi i përgjithshëm është se në mesin e femrave të martuara aborti është mjaft i pranueshëm. Femrat përmendën arsyet financiare, (nuk janë në gjendje të rrisin edhe një fëmijë), si arsye kryesore për abort. Në vazhdimësi, femrat tregojnë që kur kanë ngelur shpatëzënë menjëherë pasi që kanë lindur, aborti ishte opsion; dhe gjithashtu kur ngelnin shtatzënë dhe nuk donin të kishin më fëmijë. Kjo e fundit, aborti si metodë e planifikimit familjar, lidhet me përdorimin e përgjithshëm të metodës së nxjerrjes si metodë tradicionale. Gratë e martuara më të 'vjetra' kanë regjim të reproduktimit që përbëhet nga seksi martesor, përdorimi i metodës së nxjerrjes dhe aborti. Femrat shprehin se (shih më vonë) edhe pse ato planifikojnë të përdorin metoda moderne kontraceptive pas abortit, ato shpesh hezitojnë të përdorin diçka ndryshe në fakt.

Përpos çështjeve ekonomike dhe planifikimit familjar, arsye tjetër për abort ishte preferenca për meshkuj (zgjedhja e gjinisë me abort) dhe kompleksi i

gjyshes.

Abortet në mesin e femrave të pamartuara janë “ato për të cilat nuk flasim”. Edhe pse mendimet për seksin para martesës (dhe ndonjëherë për bashkëjetesën) kanë ndryshuar, veçanërisht në Prishtinë, mendimet për femrat që ngelin shtatzënë para martesës dhe nevoja e tyre për abort akoma reflekton vlerat tradicionale themelore (meshkujt duan të martohen me të virgjërat). Meshkujt reflektojnë këtë standard të dyfishtë; marrëdhëniet seksuale para-martesore duhet të ekzistojnë por ata nuk do të martoheshin me dikë që ka pasur seks para martesës.

Rezultatet e fokus grupeve në Prizren dhe Mitrovicë ishin të papritura ku veçanërisht femrat e reja fuqimisht shfaqën se e konsiderojnë abortin si mëkat dhe se nuk duhet të lejohet. Vlerat religjioze duket të jenë bazë e këtyre mendimeve. Kështu që përderisa shohim trendet e modernizmit në njërin anë, veçanërisht në Prishtinë, në anën tjetër shohim trendet e konservatizmit religjioz.

Në përgjithësi, femrat u shprehën se aborti është mëkat; femrat që kanë pasur abort tregojnë për dhimbjet, gjakderdhjen dhe ndjenjën e fajit. Disa femra ndjeheshin të traumatizuara – të pënduara për atë që kanë bërë. Besimi se aborti shkakton jo-plëshmërinë apo sterilitetin (gjëja më e keqe që mund t'i ndodhë femrës në Kosovë) e forcon besimin se aborti do të shoqërohet me “ndëshkim”. Gjinekologët në të vërtetë tregojnë se aborti i nxitur si i tillë nuk mund të shkaktojë sterilitetin por infeksionet gjatë dhe pas abortit mund të luajnë atë rol.

Pjesëmarrëset që kanë pasur aborte nuk ishin edhe aq të informuara për metodën e përdorur për abort. Shumë besime lidhur me metodat tradicionale për abort janë përmendur. Një ndër to ishte të ulurit në ujë të nxehtë, pirrja e birrës dhe bartja e gjërave të rënda.

## **Kontraceptivët**

Siç tregon studimi, nxjerrja del të jetë metoda kryesore kontraceptive e cila në përgjithësi përdoret më së shpeshti. Kjo po ashtu konfirmohet me të dhënat nga Studimi mbi Shëndetin Reproductiv (2003). Metoda e nxjerrjes është metoda më e popullarizuar dhe më e preferuar kundër shtatzënisë edhe pse jo 100 përqind efektive. Fatkeqësisht, femrat që varen nga burrat për të bërë këtë metodë të suksesshme ndonjëherë ngelin shtatzënë për shkak të pakujdesisë së burrit. Pjesëmarrëset përmendën raste kur burrat ishin neglizhentë për



shkak të ndikimit të alkoolit. Pjesëmarrëset po ashtu theksuan rëndësinë e besimit të dyfishtë në mes të burrit dhe gruas gjatë përdorimit të kësaj metode.

Femrat theksuan se mangësia kryesore e përdorimit të kontraktivëve modern siç janë pilulat, kondomët dhe spiralja, janë efektet e tyre anësore. Për shembull, spiralja mendohet të ketë si pasojë aneminë, sëmundjet e mëlçisë dhe gjakderdhje të tepërt. Po ashtu femrat theksuan se nuk donin objekte të huaja në organizëm. Pilulat për mbrojtje nga shtatzënia të quajtura ‘hapat’ mendohet se nga pjesëmarrësit se shkaktojnë rritje në peshë, rritjen e stomakut dhe gjoksit dhe jo- fertilitetin. Pjesëmarrësit shprehin pakënaqësinë seksuale gjatë përdorimit të kondomëve dhe brengosjen për mundësinë e shqyerjes.

Shumica e femrave marrin informata për kontraktivët nga ‘më tha të thashë’, (p.sh., shoqet, fqinjët, të afërmit dhe jo direkt nga profesionistët). Kondomët janë veçanërisht të zakonshëm tek të rinjtë. Ata mësuhan për kondomët nga kampanjat për mbrojtjen nga HIV virusi por jo edhe për mbrojtjen nga shtatzënia. Meshkujt e rinj që jetojnë në zonat urbane janë më të hapur ndaj kontraktivëve sesa moshatarët e tyre në zonat rurale. Në mesin e meshkujve urban në fokus grup u raportuan edhe kontraktivët emergjent.



## REKOMANDIMET

### Aborti

Fokusimi në *zgjedhjen e informuar për abort*; si bëhet; ligjin mbi abortin; por veçanërisht në:

Cilat metoda përdoren në klinika? Referoju besimeve tradicionale mbi abortin, siç tregon hulumtimi, dhe a janë të suksesshme apo jo.

Cilat janë pasojat e vërteta: dhembja, gjakderdhja, reagimet emocionale, ndikimet në shëndet? Si duhet të përballen pacientët me to?

*Këshillimi* pas abortit, veçanërisht pasojat emocionale. Shembull: në Holandë klinika e aborteve (Stimezo) ka materiale për lexim që përshkruan reaksione të ndryshme që kanë femrat pas abortit. Disa do të kenë ndjenjën e fajit, disa vetëm do të mendojnë “Mirë, e zgjedha problemin”, të tjerat do të kenë frikë se do të mbesin sterile, disa do të mendojnë se çfarë do të thonë dhe mendojnë familja e tyre. Mesazhi në material është: çfarëdo që ndien është e vlefshme; është mënyra juaj për tu përballur me të. Nëse reagimet janë të ashpra dhe të forta atëherë nevojitet këshillim i mëtutjeshëm. Materiali i këtij lloji është i lehtë për tu shkruar bazuar në ndjenjat e femrave të shprehura në fokus grupe dhe intervista të thella.

Sigurimi dhe ofrimi i *zgjedhjes së informuar* pas abortit për të gjitha llojet e *kontraktivëve* për të gjitha femrat që kanë pasur abort. Shpjego efektet anësore të perceptuara dhe reale. Vënja në shënjestër/ profili: çiftet më të vjetra që nuk duan të kenë më fëmijë (spiralja); femrat e reja: parandalimin e shtatzënisë me pilula, kondomë, spiralë.



Studimi nxjerrë në pah pasoja të rënda të qenit shtatzënë tek femrat e pamartuara. Fokusimi në *edukimin seksual* në veçanti tek të rinjtë; informimi mbi seksualitetin, shtatzëninë, pasojat e shtatzënisë, përdorimin e kontraceptivëve; abortet. Edukimi i prindërve për nevojën e të qenit i hapur, çfarë të bëhet kur vajzat e tyre ngelin shtatzëna.

Edukimi i djemëve për moralin e dyfishtë, për pranimin e seksit paramartesor por jo edhe mos pranimin për grua të femrave jo të virgjëra.

Pjesëmarrësit shfaqin nevojën për tu fokusuar në:

Fushatat për edukim seksual, veçanërisht për të rinjtë përmes TV.

Veçanërisht fushata e edukimit seksual në shkolla

Theksimi në të njëjtën kohë (bashkë me informatat për kontraceptivë) i nevojës për kujdesin para lindjes, duke theksuar vlerën e shtatzënisë dhe nevojën për shëndetin e mirë të gruas dhe fëmijës gjatë shtatzënisë.

Vënja në shënjestër:

Femrat e martuara dhe të pamartuara,

Meshkujt e martuar: informatat për kontraceptivët modern për dallim nga metoda e nxjerrjes,

Të rinjtë: edukata seksuale

Gratë shtatzëna: femrat që do të jenë shtatzëna; informatat për kontraceptivët modern për dallim nga metoda e nxjerrjes

Informatat e gjinekologëve për kontraceptivë, përfshirë edhe kontraceptivët emergjent, këshillimi.

Dallimi ndërmjet regjioneve brenda Kosovës; p.sh., Prishtina: femrat duan të kenë abortin si opsion; dallimi me pjesën tjetër të Kosovës.

Që në të vërtetë të qëllojmë, është i nevojshëm kuantifikimi i rezultateve (shih më poshtë).

## **Përdorimi i kontraceptivëve**

Sigurimi dhe ofrimi i *zgjedhjes së informuar* për të gjitha kontraceptivët në dispozicion duke përfshirë efektet anësore të perceptuara dhe reale. Vënja në shënjestër/ profili: çiftet më të vjetra që nuk duan të kenë më fëmijë (spiralja); femrat e reja: pilula, kondomë, spiralë. Veçanërisht të rinjtë: parandalimi i shtatzënisë.

Profesionistët duhet të ofrojnë informata të reja për kontraceptivët, përparësitë e tyre dhe mangësitë në të gjitha mediat; efektet anësore; efektet anësore të perceptuara: ofrimi i informatave të drejta. Tani femrat dëgjojnë për

kontraktivë nga fjalët 'më tha, të thashë'.

Studimi nxjerrë në pah pasoja të rënda të qenit shtatzënë tek femrat e pamartuara. Fokusimi në *edukimin seksual* në veçanti të rinjve; informimi mbi seksualitetin, shtatzëninë, pasojat e shtatzënisë, përdorimin e kontraktivëve; abortet. Edukimi i prindërve për nevojën e të qenit i hapur, çfarë të bëhet kur vajzat e tyre ngelin shtatzëna?

Edukimi i djemëve për moralin e dyfishtë, për pranimin e seksit paramartesor por jo edhe mos pranimin për grua të femrave jo të virgjëra.

Pjesëmarrësit shfaqin nevojën për tu fokusuar në:

Fushatat për edukim seksual, veçanërisht për të rinjtë përmes TV.

Veçanërisht fushata e edukimit seksual në shkolla

Kuantifikimi i rezultateve të studimit duhet të zbuloj:

Cilat mendime dhe besime për abortin dhe përdorimin e kontraktivëve janë më të përhapura, ku, në mesin e kujt?

Prioriteti në shënjestër (në cilat grupe të fokusohemi së pari)



## ANEKS 1 MOSTRA

**Fokus grupe = 19 grupe**

| Nr. i grupeve | Popullata në shënjestër | Mosha | Grupi etnik          | Lokacioni | Regjioni |
|---------------|-------------------------|-------|----------------------|-----------|----------|
| 1 grup        | Gjinekolog              | N/A   | Shqiptarë të Kosovës | Prishtina | Urban    |
| 2 grupe       | Meshkuj                 | 15-25 | Shqiptarë të Kosovës | Prishtina | Urban    |
|               |                         | 26-45 | Shqiptarë të Kosovës | Prizren   | Rural    |
| 12 grupa      | Femra                   | 15-25 | Shqiptarë të Kosovës | Prishtina | Rural    |
|               |                         | 15-25 | Shqiptarë të Kosovës | Prishtina | Urban    |
|               |                         | 15-25 | Shqiptarë të Kosovës | Prizren   | Rural    |
|               |                         | 15-25 | Shqiptarë të Kosovës | Prizren   | Urban    |
|               |                         | 15-25 | Shqiptarë të Kosovës | Mitrovica | Rural    |
|               |                         | 15-25 | Shqiptarë të Kosovës | Mitrovica | Urban    |
|               |                         | 26-45 | Shqiptarë të Kosovës | Prishtina | Rural    |
|               |                         | 26-45 | Shqiptarë të Kosovës | Prishtina | Urban    |
|               |                         | 26-45 | Shqiptarë të Kosovës | Prizren   | Rural    |
|               |                         | 26-45 | Shqiptarë të Kosovës | Prizren   | Urban    |
|               |                         | 26-45 | Shqiptarë të Kosovës | Mitrovica | Rural    |
|               |                         | 26-45 | Shqiptarë të Kosovës | Mitrovica | Urban    |
| 4 grupe       | Femra                   | 15-25 | Serb të Kosovës      | Mitrovica | Urban    |
|               |                         | 15-25 | Serb të Kosovës      | Caglavica | Rural    |
|               |                         | 26-45 | Serb të Kosovës      | Caglavica | Rural    |
|               |                         | 26-45 | Serb të Kosovës      | Mitrovica | Urban    |

**Intervista të thella = 18 intervista me femra që kanë pasur abort**

| Nr. i intervistave | Popullata në shënjestër    | Mosha | Grupi etnik         | Lokacioni | Regjioni |
|--------------------|----------------------------|-------|---------------------|-----------|----------|
| 9 intervista       | Femrat që kanë pasur abort | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Prishtina | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Prizren   | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Prishtina | Rural    |
|                    |                            | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Prizren   | Rural    |
|                    |                            | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Prishtina | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Prizren   | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Mitrovica | Rural    |
|                    |                            | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Mitrovica | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | Shqiptarë të Kosovë | Mitrovica | Rural    |
| 3 intervista       |                            | 15-45 | Serb të Kosovës     | Mitrovica | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | Serb të Kosovës     | Gracanica | Rural    |
|                    |                            | 15-45 | Serb të Kosovës     | Mitrovica | Urban    |
| 6 intervista       |                            | 15-45 | RAE të Kosovës      | Prishtina | Rural    |
|                    |                            | 15-45 | RAE të Kosovës      | Prishtina | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | RAE të Kosovës      | Prizren   | Rural    |
|                    |                            | 15-45 | RAE të Kosovës      | Prizren   | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | RAE të Kosovës      | Mitrovica | Urban    |
|                    |                            | 15-45 | RAE të Kosovës      | Mitrovica | Rural    |



## ANEKS 2 INSTRUMENET E PËRDORURA NË HULUMTIM

### UDHËZIM PËR DISKUTIM Udhëzuesi i moderatorit

#### **ÇËSHTJET QË DUHET KONSIDERUAR**

Konteksti i shërbimit shëndetësor:

Gjinia + kultura:

Aborti

Konteksti legal

#### **HYRJE**

Përshëndetjet e moderatorit dhe shpjegimi i objektivave të studimit:

Rregullat kryesore:

Flisni lirshëm dhe hapur mirëpo një nga një

Çështja e konfidencialitetit

Shprehni mendimin tuaj lirshëm; çoftë ai negativ apo pozitiv

Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara, vetëm këndvështrime të ndryshme; lirisht shprehni mendimin tuaj edhe pse ai mund të jetë i ndryshëm prej të tjerëve.

#### **SHËNDETI**

1. Mendoni për vizitën tuaj të fundit te mjeku gjatë 3 viteve të fundit, sa shpesh keni qenë te mjekun? Kur ishte vizita e fundit që bëtë te mjeku? Cili ishte qëllimi i vizitës te mjeku?

Prove: Shih nëse vizita ishte simptomatike apo vetëm vizitë e rregullt te mjeku.

Prove: Shprehitë për vizitë mjekësore?

Prove: Kupto shprehitë e përgjithshme të femrave për vizitë te mjeku. (Ngadal mundohuni t'i lironi pjesëmarrësit të flasin për vizitat e tyre tek gjinekologët).

2. Kur ishte vizita juaj e fundit te gjinekologu? Cili ishte qëllimi i vizitës tuaj?

Prove: Shih nëse vizita ishte simptomatike apo vetëm vizitë e rregullt te mjeku.

3. Ju lutem a mund të më thoni, ku shkojnë femrat për kujdesin para lindjes?  
Sa shpesh?  
Prove: Klinika private? Spital?
4. Si e vlerësoni shërbimin mjekësor për kujdesin para lindjes?  
Prove: Në spitale? Klinika private?
5. Në përgjithësi si e vlerësoni shërbimin për kujdesin para lindjes tani krahasuar me më herët? Pse? Cili është dallimi?  
Prove: Bëj dallimin në mes të shërbimeve të ofruara tani krahasuar me më herët.

## **MARRËDHËNIET PËRSONALE**

Pyetjet në vijim janë shumë personale, por është shumë e rëndësishme për mua ta kuptoj eksperiencën në përfundimin e shtatëzaniës. Shpresoj që do të jeni aq të sinqertë me mua sa më shumë që mundeni. Ju përkujtoj se gjithçka që thoni do të mbetet plotësisht konfidenciale, emri juaj nuk do të figuroj askund dhe askush nuk do të jetë në gjendje të lidhë këtë bisedë me ju.

6. A janë marrëdhëniet (martesa apo lidhja juaj me të dashurin) tema të cilat ju i diskutoni me të tjerët (p.sh., shokë/shoqe apo antarë të familjes)?  
Për shembull, nëse do të kishit problem me burrin apo të dashurin, a është diçka që e kishit diskutuar me njerëz të tjerë për të marrë këshilla/ndihmë?
7. A keni njerëz në jetën tuaj me të cilët bisedoni për gjëra intime si seksualiteti? (Prove: sa është e rehatshme për të diskutuar tema të tilla? A është e turpshme? A është taboo? A është "shumë personale"?)  
Nëse ke njerëz për të biseduar, kush janë ata? Nëse nuk ke njerëz për të biseduar, a do të dëshironit të kishit? Me kënd do të ishit ndër rehatshëm të bisedoni për tema të seksualitetit?
8. A e konsideroni Kosovën si shoqëri pak a shumë të hapur sa i përket pranimit të disa sjelljeve apo mendoni se njerëzit në Kosovë janë më tradicional dhe/ose paragjykes sa i përket disa sjelljeve që nuk përshtaten me norma?
9. Sa i përket marrëdhënieve seksuale, a mendoni që është në rregull që



njerëzit të kenë marrëdhënie seksuale para se të martohen? Pse po/pse jo? A është rrezik? Nëse po, çfarë rreziku?

10. A keni ndonjë pyetje apo brengë lidhur me marrëdhëniet seksuale? (Brengë lidhur me shtatzëninë e padëshiruar? Informata lidhur me kontracepsion? Brenga më të përgjithshme lidhur me ndërrimin e sjelljeve dhe vlerave në shoqëri? Etj.)

### **REPRODUKIMI DHE ABORTI**

11. Disa nga ju ndoshta keni fëmijë apo keni pasur rastin të shihni dikë në familje/shoqëri shtatzënë. Në këto raste, kush bën çfarë në familje? A është femra më e kujdesshme, si kanë ndërruar rolet? (Provo në mënyrë indirekte të kuptosh rolin e shtatëzansisë në familje; çfarë respekti familjarë merr ajo grua? Pse?)

12. Kur është mosha më e mire për një femër që të bëhet Nënë? Cili është numri ideal i fëmijëve që një qift duhet të ketë?  
Prove: Numri i meshkujve/femrave.  
Prove: Presioni nga burri/vjehrrit.

13. Krahasuar me vitet më herret, a mund ta bëjmë një krahasim të përgjithshëm lidhur me trajtimin që ka gruaja në shtëpi gjatë shtatëzansisë nga familja e saj sot?  
Prove: Sa janë të kujdesshme femrat sot krahasuar me më herret?  
Prove: Sa janë burat të kujdesshëm sot krahasuar me vitet e mëparshme?  
Prove: Po antarët tjerë në familje?

14. Çka nëse shtatëzënia është e padëshiruar? Çfarë mundësi kanë femrat, kur mbesin shtatzënë pa dëshirë?  
Prove: A është aborti opion?  
SHËNIM PËR MODERATORIN: pROVO TA PREZENTOSH SA MË JOFORMALISHT QË ËSHTË E MUNDUR DUKE THËNË ‘EPO, NDODHË. TA DISKUTOJMË LIRISHT’:

15. Kur është opion heqja dorë nga shtatëzënia? Psh. E martuar / e pamartuar, jo barazia gjinore, mosha, numri i djemve / vajzave, shëndeti?

16. Kur është shtatëzënia e padëshiruar? Si vjen deri te ajo?



17. Deri në cilin muaj të shtatëzanisë femra mund të abortoj?  
Kërko: kërko në cilin muaj?
18. Ju lutem më tregoni, çfarë mendoni për abortin në përgjithësi?  
Perceptimi i përgjithshëm për abortin?  
Prove: Shih dallimin në mes të përdorimit të fjalëve ‘abort’ dhe ‘ndër prerje e shtatëzanisë’.  
Prove: gjë e mirë vs. keqe.  
Prove: Shih aspektin kulturor të abortit  
Prove: Shih ndikimin e fesë lidhur me abortin
19. A dini kujt t’i referoheni nëse aborti është i nevojshëm? Ku referohen femrat që kërkojnë të abortojnë? Nga kush janë të shoqëruara femrat kur shkojnë për abort?
20. Ju lutem mendoni për dikë që ka pasur abort (që e njihni apo që keni dëgjuar). Mos më tregoni emrin e saj por vetëm mendon për të:  
  
I kujt ishte vendimi që ajo femër abortoj? A ka qenë i saj, burrit/partnerit të saj, diku tjetër?  
Cili ishte motive i saj për abort?  
Kërko: shumë e re për të mbajtur fëmijë, gjinia e fëmijës, e pamartuar etj? Arsye tjera?
21. A mund ta përshkruani një femër që kërkon abort: karakteristikat fizike, arsyet, motivet, martuar/e pa martuar, rrethanat familjare, etj?
22. Sipas juve, cilat janë arsyet më të shpeshta për abort?  
  
Prove: A është gjinia e fëmijës arsye për abort? Tjetër?
23. A duhet femrës t’i lejohet aborti? çka nëse shtatzënia ia rrezikon jetën?  
Pse?
24. Nëse do të gjendeshit në situatë ku do t’u nevojitej të abortoni, a do të preferonit të shkoni në spital, klinika private apo do të abortonit me ndonjë metodë tradicionale? Pse?
25. A dini ndonjë metodë që mund të përdoret për abortin? Nëse po, cila/ janë



ato? Si bëhen?

Nëse njeh ndonjë metodë: pyet: Ku e keni marrë këtë informatë?  
(provo për: miq, shokë, familje, personi mjekësor, etj.)

26. A jeni në dijeni, a ka ligj mbi abortin në Kosovë? Nëse jo, a duhet të ketë?  
Kur mund të konsiderohet aborti legal? Kur ilegal?

Prove: Aspekti kulturor

Prove: Aspekti fetar

27. Cili është numri maksimal i aborteve që femra mund të ketë? (Shënim për moderatorin: kjo pyetje është veçanërisht e lidhur me vetëdijen e femrave për numrin e aborteve që një femër mundet fizikisht t'i përballoj).

## **KONTRACEPTIVËT**

28. Çfarë mendoni për kontrceptivët? Për cilat metoda të kontrceptionit dini?

Prove: Kërko për metodat moderne dhe tradicionale.

Prove: Fokusohu në metodën e 'nxjerrjes' si metodë tradicionale kontrceptive. Provo njohuritë e të intervistuarës lidhur me 'mbrojtjen' që ofron kjo metodë.

Prove: Nëse nuk përmenden pyet veçanërisht për kondomët, tabletat dhe spiralen.

29. A mendoni se këto metoda kontrceptive kanë efekte anësore?

30. Për çfarë qëllime mendoni se kontrceptioni duhet të përdoret më së shumti?

Prove: parandalim nga shtatëzania e padëshiruar, sëmundje të ndryshme, rregullimi i menstruacioneve.

31. Ku keni dëgjuar për kontrceptionet?

Prove: Shokë, të afërm, persona mjekësor, reklama/billborda etj.

32. A e dini ku mund ti gjeni kontrceptivët nëse ju duhen? A e dini që ato open pa pagesë?

33. A i përdorni ndonjëherë nga ato? Cilat i përdorni më së shumti? (Shih nëse i përdorni modernet apo tradicionalet me shumë?). Pse?

Nëse i përdorë: Kush i sugjeron zakonisht, ju apo partneri juaj?

Nëse nuk i përdorë: Pse nuk i përdorë (Prove: shumë shtrenjtë, më pak kënaqësi, turpi etj.)

34. Në përgjithësi, a mendoni se femrat në Kosovë preferojnë më shumë abortin se sa përdorimin e kontraktivëve?  
Prove for: më lehtë? Më lehtë? (Shënim: parashtrimi i kësaj pyetje mund të ndryshoj varësisht nga grupit).

### **QFARË DUHET TË NDËRMIRET**

35. A mundet aborti të konsiderohet si ‘çështje brengosëse’ në Kosovë? A mendoni se është fenomen i përhapur?
36. A mendoni se numri i aborteve duhet të ulet? Nëse po, pse? Nëse jo, pse?
37. Çfarë duhet të ndërmiret, nëse diçka, për të zbritur numrin e aborteve në Kosovë? Kush mendoni se duhet të jetë përgjegjës për ndërmarrjen e këtyre veprimeve?

Prove: Qeveria / autoritetet, qeveria lokale/autoritetet, OJQ – të ndërkombëtare, NGO – të lokale, grupet religjioze, etj.

Si mund ta arrijnë ata këtë?

Prove: Më shumë programe edukative nëpër shkolla, më shumë qasje tek personal ‘më të rrezikuar’ – rinia, shoqëria duhet të jetë më e hapur për biseda në mënyrë që njerëzit të bisedojnë më shume për abortin, etj.



## **Pyetësi për intervista të thella me femrat që kanë pasur abortin**

### **ÇËSHJET QË DUHET KONSIDERUAR**

Konteksti i shërbimit shëndetësor:

Gjinia dhe kultura:

Aborti

Konteksti ligjor

### **HYRJE**

Përshëndetjet e intervistuesit dhe shpjegimi i objektivave të studimit:

Rregullat kryesore:

Flisni lirshëm dhe hapur

Çështja e konfidencialitetit: Ky studim është plotësisht konfidencial. Çfarëdo që thoni do të mbetet plotësisht konfidenciale dhe do të për doret vetëm për qëllime të studimit. Identiteti juaj nuk do të zbulohet kurrë dhe askush nuk do të jetë në gjendje t'ju lidhë me bisedën që do ta zhvillojmë.

Shfaqni mendimin tuaj lirshëm, si pozitiv ashtu edhe negativ.

Nuk ka përgjigje të drejta apo të gabueshme; jeni të lirshëm të shprehni mendimin tuaj.

### **KUJDESI SHËNDETËSOR**

1. Mendoni për vizitën tuaj të fundit te mjeku gjatë 3 viteve të fundit, sa shpesh keni qenë te mjeku? Kur ishte vizita e fundit që bëtë te mjeku? Cili ishte qëllimi i vizitës te mjeku?  
Prove: Shih nëse vizita ishte simptomatike apo vetëm vizitë e rregullt te mjeku.  
Prove: Shprehitë për vizitë mjekësore?  
Prove: Kupto shprehitë e përgjithshme të femrave për vizitë te mjeku.
2. Kur ishte vizita juaj e fundit te gjinekologu? Cili ishte qëllimi i vizitës tuaj?  
Prove: Shih nëse vizita ishte simptomatike apo vetëm vizitë e rregullt te mjeku.
3. Si e vlerësoni shërbimin mjekësor për kujdesin para lindjes?  
Prove: Në spitale? Klinika private?

4. Në përgjithësi si e vlerësoni shërbimin për kujdesin para lindjes tani krahasuar me më herët? Pse? Cili është dallimi?  
Prove: Bëj dallimin në mes të shërbimeve të ofruara tani krahasuar me më herët.

### **MARRËDHËNIET PERSONALE**

5. A janë marrëdhëniet (martesa apo lidhja juaj me të dashurin) tema të cilat ju i diskutoni me të tjerët (p.sh., shokë/shoqe apo antarë të familjes)? Për shembull, nëse do të kishit problem me burrin apo të dashurin, a është diçka që e kishit diskutuar me njerëz të tjerë për të marrë këshilla/ndihmë?
6. A keni njerëz në jetën tuaj me të cilët bisedoni për gjëra intime si seksualiteti? (Prove: sa është e rehatshme për të diskutuar tema të tilla? A është e turpshme? A është taboo? A është "shumë personale"?) Nëse ke njerëz për të biseduar, kush janë ata? Nëse nuk ke njerëz për të biseduar, a do të dëshironit të kishit? Me kënd do të ishit ndier rehatshëm të bisedoni për tema të seksualitetit?
7. A keni ndonjë pyetje apo brengë lidhur me marrëdhëniet seksuale? (Brenge lidhur me shtatzëninë e padëshiruar? Informata lidhur me kontracëption? Brenga më të përgjithshme lidhur me ndërrimin e sjelljeve dhe vlerave në shoqëri? Etj.)

### **REPRODUKIMI DHE ABORTI**

Pyetjet në vijim janë shumë personale, por është shumë e rëndësishme për mua ta kuptoj eksperiencën në përfundimin e shtatëzisë. Shpresoj që do të jeni aq të sinqertë me mua sa më shumë që mundeni. Ju përkujtoj se gjithçka që thoni do të mbetet plotësisht konfidenciale, emri juaj nuk do të figurojë askund dhe askush nuk do të jetë në gjendje të lidhë këtë bisedë me ju.

8. A jeni e martuar? A keni fëmijë? Nëse po, sa? Gjatë shtatëzisë tuaj, kush bën çka në familjen tuaj? A është femra më e kujdesshme, si ndryshojnë rolet? (Provo në mënyrë indirekte të kuptosh rolin e shtatëzisë në familje; çfarë respekti familjar merr ajo grua? Pse?)
9. Keni deklaruar se keni pasur abort në të kaluarën ... për cilën (cilat)



shtatëzani keni abortuar (të parën, të dytën, tjetër?); nëse ka fëmijë (sa, djem dhe/ose vajza) ose s'ka fëmijë?

10. Pse është ndërprerë kjo shtatëzani? Arsyet në përgjithësi për abortin, dhe veçanërisht për këtë shtatëzani?

Kërko: shumë e re për të mbajtur fëmijë, zgjedhja e gjinisë, e pamaruar, etj? Arsyet tjera?

11. Në atë kohë, a ishit e martuar apo në lidhje?

12. Kur kuptuat për shtatëzaninë e padëshiruar, çfarë bëtë? Si vendosët ta ndërpreni shtatëzaninë? Me kë biseduat? Me kë u konsultuat? Kush veni dosi? Çfarë ishin opsionet? Si u ndiet? Çfarë thanë burri/prindërit/vjehrrit?

13. Në rastin tënd, ku abortuat? Pse atje? Ku e morët atë informatë? Sa ishin shpenzimet?

14. Çfarë metode të abortit keni përdorur? Nëse e di cila metodë është përdorur: Si është kryer ajo? Nëse njeh metoda tjera, pyet: për cilat metoda tjera dini? Prove: Ku e keni marrë këtë informatë? (provo për: miq, shokë, familje, personi mjekësor, etj.)

15. Si ishte trajtimi në spital?

16. Çfarë ndiet pas abortit? (Pyet për fizike dhe emocionale)

17. pas abortit, a keni menduar të përdorni kontracepsion? A keni përdorur kontracepsion? Çfarë ishin ato? Nëse jo, pse jo? Cilat metoda i di? Efektet anësore të këtyre kontraktivëve? Pse i ka përdorur/pse jo?

18. Ju lutem më tregoni, çfarë mendoni për abortin në përgjithësi?  
Perceptimi i përgjithshëm për abortin?  
Prove: gjë e mirë vs. keqe.  
Prove: Shih aspektin kulturor të abortit  
Prove: Shih ndikimin e fesë lidhur me abortin

19. Deri në cilin muaj të shtatëzanisë femra mund të abortoj? Ne cilin muaj të

shtatëzanië keni abortuar ju?  
Kërko: kërko në cilin muaj?

## **KONTRACEPTIVËT**

20. Çfarë mendoni për kontraktivët? Për cilat metoda të kontravepsionit dini?  
Prove: Kërko për metodat moderne dhe tradicionale.  
Prove: Fokusohu në metodën e ‘nxjerrjes’ si metodë tradicionale kontravepsive. Provo njohuritë e të intervistuarës lidhur me ‘mbrojtjen’ që ofron kjo metodë.  
Prove: Nëse nuk përmenden pyet veçanërisht për kondomët, tabletat dhe spiralen.
21. A mendoni se këto metoda kontravepsive kanë efekte anësore?
22. Ku keni dëgjuar për kontravepsionin?  
Prove: Shokët, të afërmit, personeli mjekësor etj.
23. A e dini ku mund ti gjeni kontraktivët nëse ju duhen? A e dini që ato jipen pa pagesë?
24. A i përdorni ndonjëerën nga ato? Cilat i përdorni më së shumti? (Shih nëse i përdorin modernet apo tradicionalet me shumë?). Pse?  
Nëse i përdorë: Kush i sugjeron zakonisht, ju apo partneri juaj?  
Nëse nuk i përdorë: Pse nuk i përdorë (Prove: shumë shtrenjtë, më pak kënaqësi, turpi etj.)
25. Çfarë mendoni se është më e mirë/lehtë, aborti apo kontravepsioni? Pse?
26. Cilat janë planet në të ardhmen për shtatëzanië/fëmijët?



## UDHËZIM PËR DISKUTIM - Grupi me Gjinekologë Udhëzuesi i moderatorit

### **ÇËSHTJET QË DUHET KONSIDERUAR**

Konteksti i shërbimit shëndetësor:

Gjinia + kultura:

Aborti

Konteksti legal

### **HYRJE**

Përshëndetjet e moderatorit dhe shpjegimi i objektivave të studimit:

Rregullat kryesore:

Flisni lirshëm dhe hapur mirëpo një nga një

Çështja e konfidencialitetit

Shprehni mendimin tuaj lirshëm; çoftë ai negative apo pozitiv

Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara, vetëm këndvështrime të ndryshme; lirisht shprehni mendimin tuaj edhe pse ai mund të jetë i ndryshëm prej të tjerëve.

### **SHËNDETI**

1. Mendoni për vizitat e pacientëve tuaj. Sa shpesh vijnë femrat tek ju (pyet për pacientë të rregullt)? Kur ishte vizita juaj e fundit që bëtë te mjeku? Cili ishte qëllimi i vizitës te mjeku?

Prove: Shih nëse vizita ishte simptomatike apo vetëm vizitë e rregullt te mjeku.

Prove: Për qëndrimin e femrave ndaj vizitave tek mjeku?

Prove: Kupto shprehitë e përgjithshme të femrave për vizitë te mjeku.

2. Ju lutem a mund të më thoni, sa shpesh vijnë femrat për kujdesin para lindjes?

Prove: Klinika private? Spital?

3. Si e vlerësoni shërbimin mjekësor për kujdesin para lindjes? Ku shkojnë ato më së shpeshti? Klinika private apo spitale?

4. Në përgjithësi si e vlerësoni shërbimin për kujdesin para lindjes tani krahasuar me më herët? Pse? Cili është dallimi?



Prove: Bëj dallimin në mes të shërbimeve të ofruara tani krahasuar me më herët.

## **REPRODUKIMI DHE ABORTI**

5. Jam i sigurt që shumica prej jush shihni gra shtatzëna në klinikat/spitalet ku punoni. Si trajtohen femrat zakonisht nga shoqëruarit e tyre? Nga kush janë ato zakonisht të shoqëruara?
6. Kur është mosha më e mirë për një femër që të bëhet Nënë? Cili është numri ideal i fëmijëve që një çift preferon të ketë?  
Prove: Numri i meshkujve/femrave.  
Prove: Presioni nga burri/vjehrit.
7. Krahasuar me vitet më herët, a mund ta bëni një krahasim të përgjithshëm lidhur me trajtimin që ka gruaja në shtëpi gjatë shtatzënisë nga familja e saj sot?  
Prove: Sa janë të kujdesshme femrat sot krahasuar me më herët?  
Prove: Sa janë burat të kujdesshëm sot krahasuar me vitet e mëparshme?  
Prove: Po antarët tjerë në familje?
8. Çka nëse shtatzënia është e padëshiruar? Çfarë mundësi zgjedhin femrat, kur mbesin shtatzënë pa dëshirë?  
Prove: A është aborti opsion?
9. Kur është opsion heqja dorë nga shtatzënia? Psh. E martuar / e pamartuar, jo barazia gjinore, mosha, numri i djemve / vajzave, shëndeti?
10. Kur është shtatzënia e padëshiruar? Si vjen deri te ajo?
11. Deri në cilin muaj të shtatzënisë femra mund të abortoj?  
Kërko: kërko në cilin muaj?
12. Ju lutem më tregoni, çfarë mendoni për abortin në përgjithësi?  
Perceptimi i përgjithshëm për abortin?  
Prove: Shih dallimin në mes të përdorimit të fjalëve 'abort' dhe 'ndërprerje e shtatzënisë'.  
Prove: gjë e mirë vs. keqe.  
Prove: Shih aspektin kulturor të abortit



Prove: Shih ndikimin e fesë lidhur me abortin

13. Ju lutem mendoni për dikë që ka pasur abort më herët. Mos më tregoni emrin e saj por vetëm mendon për të:

I kujt ishte vendimi që ajo femër aborto? A ka qenë i saj, burrit/partnerit të saj, dikujt tjetër?

Cili ishte motivi i saj për abort?

Kërko: shumë e re për të mbajtur fëmijë, gjinia e fëmijës, e pamartuar etj? Arsye tjera?

14. A mund ta përshkruani një femër që kërkon abort: karakteristikat fizike, arsyet, motivet, martuar/e pa martuar, rrethanat familjare, etj?

Kush kërkon abort më shumë, femrat e reja apo të vjetrat?

15. Sipas juve, cilat janë arsyet më të shpeshta për abort?

Prove: A është gjinia e fëmijës arsye për abort? Tjetër?

Deri në cilin muaj të shtatzënisë femra mund të aborto? A janë këto raste kur femrat kërkojnë abort në muajt e fundit të shtatzënisë? A është kjo e lejuar? Çfarë do të bënit ju në atë rast?

16. A duhet femrës t'i lejohej aborti? Çka nëse shtatzënia ia rrezikon jetën? Pse?

17. Duke u bazuar në fokus grupet tona të mëhershme me femra, ato më së shumti preferojnë të kenë abort në klinikat private. Çfarë mendoni, cilat janë arsyet kryesore për këtë?

18. Cilat metoda i përdorni për abortin? Si bëhen ato?

19. A jeni në dijeni, a ka ligj mbi abortin në Kosovë? Nëse jo, a duhet të ketë? Kur mund të konsiderohet aborti legal? Kur ilegal?

Prove: Aspekti kulturor

Prove: Aspekti fetar

20. Cili është numri maksimal i aborteve që femra mund të ketë? (Shënim për

moderatorin: kjo pyetje është veçanërisht e lidhur me vetëdijen e femrave për numrin e aborteve që një femër mundet fizikisht t'i përballoj).

### **KËSHILLIMET PARA DHE PAS ABORTIT**

21. Sipas mendimit tuaj, a mendoni që mjekët ju ofrojnë këshillim para abortit femrave që dëshirojnë të kenë abort? (kërko për efektet anësore, rëndësinë e fëmiut, reziqet).

22. Po këshillimet pas abortit? A i këshillojnë mjekët femrat që kanë pasur abort, lidhur me kontraktivët? Si reagojnë femrat zakonisht në këto raste? (të interesuara/të pa-interesuara)

Si ndihen femrat pas abortit? (Pyet për gjendjen fizike dhe emocionale, në këtë rast fokusohu më shumë në ndjenjat e femrave).

### **KONTRACEPTIVËT**

23. Çfarë mendoni për kontraktivët? Për cilat metoda të kontraksionit janë femrat më së shumti të vetëdijshme?

Prove: Kërko për metodat moderne dhe tradicionale.

Prove: Fokusohu në metodën e 'nxjerrjes' si metodë tradicionale kontraktive. Provo njohuritë e të intervistuarës lidhur me 'mbrojtjen' që ofron kjo metodë.

Prove: Nëse nuk përmenden pyet veçanërisht për kondomët, tabletat dhe spiralen.

24. A mendoni se këto metoda kontraktive kanë efekte anësore?

25. Ku dëgjojnë femrat më së shumti për metodat kontraktive?

Prove: Shokë, të afërm, persona mjekësor, reklama/billborda etj.

26. A e dinë ato ku mund ti gjejnë kontraktivët nëse ju duhen? A e dinë ato që kontraktivët jipen pa pagesë?

27. Çfarë mendoni, a i përdorin ndonjëherë nga ato? Cilat i përdorin më së shumti? (Shih nëse i përdorin modernet apo tradicionalet me shumë?). Pse?



Nëse i përdorë: Kush i sugjeron zakonisht, ju apo partneri juaj?  
Nëse nuk i përdorë: Pse nuk i përdorë (Prove: shumë shtrenjtë, më pak kënaqësi, turpi etj.)

28. Në përgjithësi, a mendoni se femrat në Kosovë preferojnë më shumë abortin se sa përdorimin e kontraktivëve?  
Prove for: më lehtë? Më lehtë? (Shënim: parashtrimi i kësaj pyetje mund të ndryshoj varësisht nga grupit).

### **ÇFARË DUHET TË NDËRMIRET**

29. A mundet aborti të konsiderohet si ‘çështje brengosëse’ në Kosovë? A mendoni se është fenomen i përhapur?
30. A mendoni se numri i aborteve duhet të ulet? Nëse po, pse? Nëse jo, pse?
31. Çfarë duhet të ndërmiret, nëse diçka, për të zbritur numrin e aborteve në Kosovë? Kush mendoni se duhet të jetë përgjegjës për ndërmarrjen e këtyre veprimeve?  
  
Prove: Qeveria / autoritetet, qeveria lokale/autoritetet, OJQ – të ndërkombëtare, NGO – të lokale, grupet religjioze, etj.
32. Si mund ta arrijnë ata këtë?  
  
Prove: Më shumë programe edukative nëpër shkolla, më shumë qasje tek personat ‘më të rrezikuar’ – rinia, shoqëria duhet të jetë më e hapur për biseda në mënyrë që njerëzit të bisedojnë më shume për abortin, etj.

## SHENIMET

1. Kosovo Human Development Report – 2004 (United Nations Development Program)
2. Kosovo Human Development Report – 2004 (United Nations Development Program)
3. Statistical Office of Kosovo
4. Voice Of Women Report – 2004 (United Nations Development Agencies)
5. UNMIK Regulation No. 2001/27
6. Voice Of Women Report – 2004 (United Nations Development Agencies)
7. International Monetary Fund, 2003
8. Voice of Women –report (December, 2004) – UN Development Agencies
9. Voice of Women –report (December, 2004) – UN Development Agencies
10. Voice of Women –report (December, 2004) – UN Development Agencies
11. Kanuni i Lekë Dukagjinit – rewritten by Shtjefën Konstantin Gjeçovi
12. UNICEF Kosovo – June 2004
13. Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë – 2004 (Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara UNDP)
14. Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë – 2004 (Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara UNDP)
15. [http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Induced\\_abortion](http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Induced_abortion)
16. [http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Induced\\_abortion](http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Induced_abortion)
17. [http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Health\\_effects](http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Health_effects)
18. [http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Health\\_effects](http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Health_effects)
19. [http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Forms\\_of\\_abortion](http://en.wikipedia.org/wiki/Abortion#Forms_of_abortion)
20. Ligji mbi abortin në Kosovë akoma nuk është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i tanishëm në funksion është ai Ligj që është përdorur qysh para konfliktit në vitin 1999
21. <http://www.plannedparenthood.org>
22. Reproductive Tract Infection/ Sexually Transmitted Infections in Kosova - National Institute of Public Health of Kosova Department of Epidemiology, 2003
23. <http://www.plannedparenthood.org>
24. <http://www.plannedparenthood.org>

